

**Listat**  
Lekturat,  
jo brez  
pas brezi

Fq.6



**KRIMINELËT  
E FEJSBUKUT**  
Zbulohen  
kërcënuesit  
e Zaevit

Fq.5



Paguan  
"gjobat e  
burkës"  
edhe në  
Danimarkë

Fq.17



# Koha

www.koha.mk



Synoj të  
bëhem  
kampion bote

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3314 · e hënë 12 mars, 2018

7°C | 17°C

15 DEN

## FORUM

**Gruevizëm  
dhe me  
Zaevin pa  
zaevizëm**



Gruevski iku. Nuk iku, por e përzunë. Një dëshirë e madhe e shqiptarëve u plotësua. Bile edhe mund të lavdërohen se pa ndihmën e shqiptarëve, për LSDM-n edhe shumë gjatë do të sundonte. Kush çka fitoj ende nuk mund të përlllogarisim por një gjë e dimë, hija e tij nuk na hiqet. Sa për të mos na marrë "malin" çdo ditë e shohim nëpër TV duke u endur lartë poshtë nëpër gjykata pa epilog...

Fq.10

## DOSSIER

**Serbia përballë  
tapive të  
Sanxhakut  
të Nishit**

Fq.18-19

## RAJON

**Dorëheqjet  
e deputetëve,  
fillimi i  
fundit i  
Vetëvendosjes**

Fq.16



## LIGJI I GJUHËVE MBETET I BLOKUAR NË PARLAMENT

# BDI THOTË SE S'KA PAZAR, VMRO NUK HEQ DORË!



"Për BDI dhe partnerët e koalicionit Ligji për gjuhën nuk është pjesë e kushtëzimeve po edhe e kërcënimeve nëse ekzistojnë, për ligjin nuk ka negociata nuk ka kalkulime nuk ka pazarllëqe aq më tepër kur e dimë se VMRO është kundër saj", thotë deputeti Xhevat Ademi. Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, ritheksoi se partia e tij nuk ka ndryshuar qëndrim, ndërsa përsëriti se deputetët e tij nuk heqin dorë nga shqyrtimi një nga një i amendamenteve

Fq.3

## Optimizëm për marrëveshjen e Këshillin

Tetovë, 11 mars - Në fund të muajit mars, kur edhe është afati i fundit për formimin e shumicës në Këshillin e komunave, pritet të përfundojë ngërçi edhe në Këshillin e Komunës së Tetovës. Pas zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar, Komuna e Tetovës vazhdon të funksionojë pa Këshillin komunal, respektivisht pa krijimin e shumicës. Kryetarja e Komunës, Teuta Arifi, megjithatë shpreson se deri në fund të muajit

do të ketë marrëveshje, pa dhënë detaje se me cilin apo cilët subjekte do të krijohet kjo shumicë. "Në fund të muajit mars presim të arrijmë marrëveshje për krijimin e shumicës në Këshillin e Komunës së Tetovës. Edhe njëherë po e them se atmosfera në të cilën zhvillohet ky proces është konstruktive dhe në fund të muajit mars të fillojë të funksionojë Këshilli normalisht. Siç e dini, Këshilli ka mbajtur...

Fq.9



## EDITORIAL

## FURTUNA QË SOLLI LIRINË



Emin AZEMI

Ngjarjet e mëdha të një kombi bëhen të pavdekshme vetëm atëherë kur sendërtohen idetë dhe synimet e atyre që flijohen për ato ngjarje. Nëse 81-shi i para 37 vjetëve ishte pranvera e një epoke që do të sillte ndryshime, rezistenca politike-ushtarake e viteve që pasuan ishte fryti i pjekur i një stine të mbarsur me dijen dhe përvojën e gjeneratave përditë të atdhetarëve dhe me guximin dhe vendosmërinë e gjeneratave të mëvonshme.

Nëse i referohemi shtypit të kohës, demonstratat e vitit 1981 në Kosovë nuk erdhën vetvetiu, por ato paten një parahistori dhe një zhvillim pararendës të ngjarjeve dhe proceseve. Që nga lëvizja e Adem Demaçit për bashkim, si dhe platforma nacionale e Metush Krasniqit, e deri në ditët që inicuan rezistencën e armatosur, trajektorja e aksionit politik shqiptar kishte shënuar rritje dhe përmasa mobilizuese.

Në vitin 1978 gjithkund ku flitej shqip kremtohej 100 vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ishte ky vit që të përkujtonte zgjimin kombëtar që kishte ndodhur një shekull më par, por shumë aktual për nga porosia dhe vizioni edhe pas një shekulli. Po në këtë vit, sipas të dhënave që arritëm t'i sigurojmë në vitet që pasuan, studentët shqiptarë si në Kosovë, ashtu edhe në Zagreb, Lubjanë, Sarajevë, Beograd, Shkup kishin pyetur vesh më vesh: Kur do t'ia fillojmë kryengritjes kundër pushtuesit sllav si në kohën e Turqisë? "Josip Broz Tito ka vdekur më shumë se një vit, por "bashkim-vëllazërimi" jugosllav i ushqyer prej tij tani më ka zhvilluar çarje në një krah të ndjeshëm të saj, krahinën serbe me shumicë shqiptare, Kosovën", shkruante, më 19 prill 1981, gazetari i famshëm amerikan Dejvid Bajnder, në gazetën "New York Times". Teksti i tij titullohej: "Një furtunë kaloi, por tjerat janë duke u mbledhur në Jugosllavi". Furtuna e Kosovës, ndonëse u shfaq herët në qiellin e vrenjtur të Jugosllavisë së atëhershme, megjithatë lëkund status-quon e krijuar në vitet shtatëdhjetë, sidomos pas kushtetutës së v. 1974. Për të mos rënë në kurthën e paqes së rreme, viti 1981 përgatiti një epokë të re jo vetëm për Kosovën, por edhe për gjithë rajonin, duke i dhënë ritmit të kohës kërkesa të reja për ndryshim. Në fjalimin e prof. Ukshin Hotit mbajtur në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, më 19 nëntor 1981, do të vërejmë se Kushtetuta e v. 1974 ishte rezultat i demokratizimit të mëtejshëm të jetës politike dhe shoqërore, por, sipas prof. Hotit, gjithsesi nuk mund të thuhet se kjo ishte e lidhur me ndryshimet dhe aprovimet e kushtetutave demokratike të vendeve të tjera. Viti 1981 figurativisht është quajtur edhe "pranvera e Kosovës". Studentët dhe rinia përparimtare e asaj kohe pakënaqësitë e veta sociale shumë shpejt i mbindërtoi në afinitete politike. Menza e studentëve ishte bërë epiqendra e kësaj drame të madhe, për t'u zgjeruar pastaj në një preokupim gjithëkombëtar. Në Universitetin e Kosovës, atë botë studionin të rinj nga të gjitha viset shqiptarë. Pati shumë të tillë edhe nga Maqedonia. Këta të fundit u bënë në një fare mënyre kasnecët e pare të kësaj pranvere edhe në vendlindjet e tyre. Organet e ndjekjes po survejonin me vëmendje këto lëvizje dhe po evidentonin efektet e ngjarjeve të Kosovës në hapësirën e Maqedonisë. Filloi mobilizimi politik. Goditjet e para i përjetoi arsimit shqip në Kumanovë, Kërçovë, Strugë, Gostivar e gjetiu. Inkriminimi policor e juridik i dhjetëra arsimtarëve, për pasojë pati burgosjet, largimin nga puna, por edhe arratisjen nga vendi. Në Kërçovë, Kumanovë, Tetovë filloi të gatuhej një bukë e re, që do të ushqente më vonë gjeneratat të tëra me ideale lirisdashëse, për të kurorëzuar një vepër kapitale për interesat e shqiptarëve dhe të demokratizimit të përgjithshëm të shoqërisë, siç ishte fillimisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës e më pas Ushtria Çlirimtare Kombëtare.


Në planin politik, viti 1981 do të ndikojë në kanalizimin e energjive krijuese të njerëzve, duke i dhënë emancipimit shoqëror një kualitet të ri mendimi, por edhe një barometër që do të maste kapacitetet vepëruese në terren. Kalitja e një gjenerate të re vepërmartarësh që u sprova në ditët e vështira të ilegalitetit, ishte e pamundur të vine sikur të mos ndodhte 81-shi. Ndonëse shumë veta këtë shkollë të jetës e pagoi edhe me dhjetëra vjet burgim dhe izolim, megjithatë, logjika e kohës solli atë që në dialektikë quhet rrjedhoja e shkak pasojave.

## HEM TË VË PLAK, HEM TË RRUAN MJEKRËN

"Sot e kaq ditë më parë, një 'mik imi' nga fëmijëria, më parashtrroi pyetjen: 'ore qerrata, pse, emri im nuk duket në listën e pjesëmarrësve të demonstratave të motit 1968!?'.

Aa ktheva "hazërxevapin": po si mund të duket, kur ti asokohe gjegjësisht, me 25 maj, degdise në Beograd, të shohësh se si i dorëzohet stafeta e rinisë (штафета младости- дан младости), josip broz titos..., sikur nuk i mjaftoi përgjigja ime, dhe më tha: "unë kam prova bindëse!" i thash: argumentet i ke komprometues!

Këtij "muhabeti prej pazari", i shkon ajo shprehja proverbiale: 'hem të vë plak, hem të rruan mjekrën', shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti nga Tetova, Fadil Lushi.



## EKSPERIMENTI I RREZIKSHËM ME KOMUNAT SHQIPTARE NË MAQEDONI

"Edhe nga regjimet më të egra ndaj shqiptarëve, si në kohën e Rankoviçit dhe regjimin e Millosheviçit, është gjetur nga pushteti okupator serb ndonjë mercenar shqiptar si Sejdo Bajramoviç, ose 'Hajrie Spikerica', por nuk janë bllokuar komunat, formimi i Këshillave komunale dhe miratimi i buxheteve, si në Komunën e Tetovës, Komunën e Gostivarit dhe disa komuna të tjera me shumicë shqiptare, siç janë bllokuar sot, pas zgjedhjeve të fundit vendore në Maqedoni. Pushteti duhet të mbajë përgjegjësi për këtë EKSPERIMENT tepër të rrezikshëm, meqë partitë politike të shqiptarëve ka kohë që e kanë humbur kuptimin për politikë, demokraci, llogaridhënie dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve", shkruan në profilin e tij në FB, prof. Abdulla Mehmeti.



## EVN DUHET PËRZËNË NGA MAQEDONIA

"Përsëritës këtë nismë, të cilën duhet çuar vendosmërisht dhe masivisht gjer në fund. EVN është instrumenti më kolonial që është instaluar në Maqedoni për zhatjen e shqiptarëve dhe me politikë të mbrapshtë, poshtëruese ndaj shqiptarëve.

Është aty e aplikuar një taksë prej 33 për qind që e paguajnë vetëm familjet shqiptare dhe ka indicie të bazuara se kjo përveç ndarjes së përbashkët që e bëjnë gjoja "aksionarët" pjesa më e madhe shkon në konton (si aksione) të aksionarit shqiptar që fillimisht ka hyrë aty me 22 për qind të aksioneve dhe kujtoj që e dini, cili është dhe i cili është ai që e ka sjellë EVN-në në Maqedoni përmes një ryshfeti dhënë qeverisë së atëhershme prej 5 milionë eurosh dhe kjo lëndë penale u fol njëherë se është depozituar te PS, po heshtet.

Të mos flasim edhe për poshtërimet të tjera që na bën në mospunësimin proporcional të shqiptarëve, në mospërdorimin e gjuhës shqipe si e drejtë themelore prej konsumatori etj. Pra, përpara dhe pakthim në këtë nismë...!", shkruan publicisti nga Tetova, Nijazi Muhamedi



## MEDIACitate

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë përgatitur një "paketë speciale", e cila javëve të ardhshme do t'i prezantohet fillimisht presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Kështu së paku shkruar e përditshmja serbe "Novosti", duke u thirrur në burime. Sipas burimit të kësaj gazete, ky dokument i Washingtonit, me një notë të theksuar gjeopolitike, ka të bëjë drejtpërsëdrejti me statusin e Kosovës dhe i cili mund të përcaktojë në masë të madhe drejtimin e mëtejshëm strategjik të Serbisë, transmeton Koha.net. "Teksti i Kosovës" i Administratës Trump, për të cilin mund të flitet qysh sot kur në Beograd të arrijë Wes Mitchell, ndihmësi i ri i Sekretarit të Shtetit për Evropë dhe Euro-Azi, përmban disa pika kyçe: - parashih që Asociacioni i komunave serbe të marrë kompetenca të gjera ekzekutive dhe kompetenca të zgjeruara në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe kulturës - Asociacioni do të ishte i lidhur ngushtë institucionalisht me zëvendëskryeminstirin e Qeverisë së Kosovës, i cili do të vinte nga radhët e serbëve dhe i cili praktikisht do të ishte kontrollues i punës së saj dhe ushtrimit të autoritetit - nga Beogradi pritet të mundësojë anëtarësimin e Prishtinës në organizata ndërkombëtare - nëse pala serbe pranon këtë pako, Serbisë do t'i lejohet anëtarësimi në Bashkimin Evropian, ndërsa SHBA-ja do t'i garantonte mbështetje të gjerë ekonomike dhe diplomatike në arenën ndërkombëtare politike "Novosti" thotë se qarqet e tyre diplomatike vlerësojnë se ky hap i Amerikës është ndërmarrë pasi që janë të pakënaqur me Brukselin inert kur bëhet fjalë për çështjen e Kosovës. "Po ashtu, në kontekstin e opsioneve gjithnjë e më joformale mbi ndarjen e Kosovës dhe Metohisë, administratës së Washingtonit nuk i konvenon që Beogradi edhe de jure të marrë veriun, sepse do të krijonte një 'zonë tampon' midis boshnjakëve dhe shqiptarëve, aleatëve të tyre të besuar, ndërsa Serbia do të merre kontrollin e Kopaonikut dhe Zubin Potokut, të cilat janë pika të rëndësishme strategjike".

(Novosti, 11 mars)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

## AKA PASUR TRADITA TË DETARISË NË SHQIPËRI?

I nderuar lexues! Shqiptarët trashëgojnë tradita të lashta të detarisë. Në periudhën e ilirëve fisi i parë më i përmendur për detari të zhvilluar ishin japodët dhe pas tyre liburnët me anijet liburnide të famshme.

Nën mbretërinë e Agronit, Teutës e Gentit fuqia detare ilire u rrit. Nën pushtimin romak, bizantin e venedikas, aftësitë për detari të vendësve u shfrytëzuan për fuqizimin e flotave të

sunduesve. Me principatat shqiptare të mesjetës tradita e detarisë u përtërinë. Balshajt, Topiajt u përpoqën të krijojnë flotat e tyre tregtare e luftarake.

Në shek. XVII-XVIII vetëm Ulqini kishte 500 mjete lundrimi të ndërtuara në vend. Detaria shqiptare filloi të bjerë në shek. XIX për arsye të konkurrencës nga shoqëritë e mëdha evropiane të lundrimit.

LIGJI I GJUHËVE MBETET I BLOKUAR NË PARLAMENT

# BDI THOTË SE S'KA PAZAR, VMRO NUK HEQ DORË!



"Për BDI dhe partnerët e koalicionit Ligji për gjuhën nuk është pjesë e kushtëzimeve po edhe e kërcënimeve nëse ekzistojnë, për ligjin nuk ka negociata nuk ka kalkulime nuk ka pazarllëqe aq më tepër kur e dimë se VMRO është kundër saj", thotë Ademi

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 11 mars - Për ligjin e gjuhëve nuk ka negociata nuk ka kalkulime nuk ka pazarllëqe aq më tepër kur e dimë se VMRO është kundër saj. Kështu për Dojçe Vele ka deklaruar deputeti i Bashkimit Demokratik për Integritet, Xhevat Ademi, sipas të cilit, megjithatë për BDI-në dhe partnerin e koalicionit - LSDM, ligji në fjalë nuk është pjesë e kushtëzimeve mes vete.

"Për BDI dhe partnerët e koalicionit ligji për gjuhën nuk është pjesë e kushtëzimeve po edhe e kërcënimeve nëse ekzistojnë, për ligjin nuk ka negociata nuk ka kalkulime nuk ka pazarllëqe aq më tepër kur e dimë se VMRO është kundër saj", thotë Ademi.

Në ndërkohë, kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, i quan lojëra veprimet e partnerëve të koalicionit lidhur me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. "Kjo është shkelje e marrëveshjes dhe burrat në këto raste dihet se çfarë veprime duhet marrin. Nëse kanë burrëri dhe janë të vendosur në politikbërje, BDI duhet të ulet dhe ta bisedojë këtë çështje me Zoran Zaevin dhe nëse nuk kalon ligji për gjuhët duhet ta lëshojë Qeverinë", vlerëson Sela. Lëvizja

BESA, e cila në leximin e parë dhe të dytë votoi për Ligjin për përdorimin e gjuhëve, thekson shqetësimin për dështimin e miratimit të tij. Nga ky subjekt ritheksojnë se edhe më tej do ta mbështesin ligjin në fjalë. "Jemi seriozisht të shqetësuar që shumica nuk arrin ta sjellë ligjin në seancë plenare. Ne e kemi thënë se ky ligj nuk e zyrtarizon shqipen, por vetëm e avancojmë pak, duke e lënë hapur këtë temë, por sidoqoftë edhe si të tillë ne do ta mbështesim. Ne jemi këtu që të ndihmojmë e jo të bllokojmë", thonë nga Lëvizja Besa. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka përsëritur se ka shumë dallime mes partisë së tij dhe VMRO-DPMNE-së sa i përket miratimit të Ligjit për gjuhën shqipe. "Propozimi që të formohet një grup pune me ekspertë nga e drejta kushtetuese, të cilët do të komentojnë Ligjin për ne është i papranueshëm, për shkakë parimore dhe pragmatike, sepse në Maqedoni ekziston Gjykata Kushtetuese dhe nëse diçka është në kundërshtim me Kushtetutën, për këtë do të duhet të prononcohet Gjykata Kushtetuese", ka theksuar kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev.

Kryeparlamentari Talat Xhaferi ditë më parë mohoi se ka një plan rezervë për realizimin e votimit të domosdoshëm që ligji

të hyjë në fuqi. "Kryetari i Parlamentit nuk ka plane të tilla në punën dhe në funksionimin e Parlamentit. Kryetari i Parlamentit para vetes ka kushtetutën dhe Rregulloren e punës së Parlamentit, në të cilin janë të sanksionuara kompetencat e caktuara dhe procedurat e caktuara", tha Xhaferi. Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, të shtunën ritheksoi se partia e tij nuk ka ndryshuar qëndrim, ndërsa përsëriti se deputetët e tij nuk heqin dorë nga shqyrtimi një nga një i amendamenteve. "Presin shqyrtimin e amendamenteve konform Rregullores.

Absolutisht ne në harmoni me procedurat kemi parashtruar amendamente. Ato amendamente kanë hyrë në procedurë parlamentare. Presim respektim të Rregullores për punë të Parlamentit, respektim të ligjeve dhe Kushtetutës. Si parti angazhohemi për respektimin e së drejtës dhe s'do tolerojmë asgjë tjetër", thotë kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski. Ndryshe, Ligji për përdorimin e gjuhëve u votua më 11 janar, ndërsa më 17 janar presidenti Gjirgje Ivanov njoftoi mos dekretimin e tij. Miratimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, pas dy tentimeve të dështuara, është pezulluar në afat të pacaktuar.

## OSMANI: KËTË JAVË LIGJI PËR GJUHËT PARA DEPUTETËVE

Këtë javë do të votohet Ligji për gjuhët, thotë në një deklaratë për televizionin "Telma" zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane Bujar Osmani. Ai e hodhi poshtë mundësinë për ndryshimin e tekstit, sepse, siç tha, ai është harmonizuar paraprakisht me dy partitë më të mëdha në bllokun maqedonas. "Javën e ardhshme ligji për gjuhët sërish do të gjendet para deputetëve dhe pritet të votohet për të mirën e Republikës së Maqedonisë", tha Osmani për televizionin. Sipas Osmanit, kjo Qeveri që në fillim ka vendosur të përballlet me tre

pengesa të mëdha në rrugën eurointegruese - marrëdhëniet e këqija me Bullgarinë, kontestin me emrin dhe përdorimin e gjuhës shqipe. "Jam i bindur se nëse e tregojmë përkushtimin dhe guximin e njëjtë për ta sjellë ligjin, ndërsa do ta sjellin në ditët në vijim, gjithashtu marrëdhëniet ndëretnike do të jenë mbështetja më e madhe për ne, fuqia më e madhe inkurajuese që shteti të anëtarësohet në strukturat euroatlantike dhe më pas të mbetet çështja e fundit dhe ajo është çështja e emrit", tha Osmani.



## Borisovi sot në Shkup

Shkup, 10 mars - Në kuadër të shënimit të 75-vjetorit të Holokaustit të hebrejve në Maqedoni, sot në Shkup do të marrë pjesë edhe kryeministri bullgar Bojko Borisov. Siç publikoi pres shërbimi qeveritar, kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev dhe kolegu i tij bullgar Borisov do të vendosin lule në përmendoren e 7.144 hebrejve nga Maqedonia, ku janë paralajmëruar edhe fjalime të tyre si dhe të kryetares së Komunitetit hebre në Maqedoni, Berta Romano Nikoliq. Pas marshit delegacionet do të drejtohen drejt Kuvendit të RM-së ku janë parashikuar mbajtje e seancave komemorative. Bojko Borisov është kryeministri i parë bullgar që merr pjesë në kremtimin e përvjetorit të deportimit të hebrejve nga Maqedonia. Në delegacionin zyrtar bullgar, në kremtimin e 75 vjetorit të deportimit të hebrejve nga Maqedonia do të marrin pjesë edhe përfaqësues të bashkësisë hebraike në Bullgari, njofton BTA. Në kuadër të festimit të 75 vjetorit të Holokaustit të hebrejve të Maqedonisë në Luftën e Dytë Botërore, nesër dhe pasnesër janë planifikuar aktivitetet në Manastir, në Shtip dhe në Shkup. Gjatë Luftës së Dytë Botërore nga Maqedonia janë deportuar 7114 hebrej, të cilët janë çuar në kampin e përqendrimit të Treblinës në Poloni.

## Emri, grekët frikësohen se do fitojë Maqedonia

Athinë, 10 mars - Më shumë se gjysma e të anketuarve (57.1 për qind) në hulumtimin e realizuar për televizionin grek "Action 24" vlerësojnë se zgjidhja eventuale e problemit me emrin do të jetë më afër qëndrimeve të Maqedonisë, ndërsa vetëm 26.9 për qind më afër "vijave të kuqe" greke. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, në pyetjen: "Zgjidhja që do të përzgjidhet për emrin e Shkupit, vlerësoni se do të jetë më afër asaj që e kërkon Greqia apo asaj që e kërkon Shkupi?", gjashtë deri 10 të anketuar janë përgjigjur se do të jetë në dobi të Maqedonisë. Në këtë pyetje 57.1 për qind janë përgjigjur se do të jetë më afër asaj që e kërkon Shkupi, 26.9 për qind më afër asaj që e kërkon Athina, ndërsa 16 për qind kanë thënë se nuk e dinë ose kanë shmangur përgjigjen. Në hulumtimin e mendimit publik, për çështjen konkrete është bërë analizë sipas orientimit politik, moshës, gjinisë, vendbanimit, shkallës së edukimit e të ngjashme. Prej tyre 57.1 që janë përgjigjur se zgjidhja do të jetë më afër kërkesave të Maqedonisë, shumica 74.5 për qind në zgjedhjet e fundit parlamentare në shtator të vitit 2015 kanë votuar për Demokracinë e Re opozitare, ndërsa 39.7 për qind për Syrizen. Pothuajse 7 prej 10 të anketuarve që vlerësojnë se zgjidhja do të jetë në dobi të Maqedonisë, vetëpërcaktohen si djathtistë apo djathtistë radikalë. Lidhur me gjininë, dallimi mes burrave dhe grave është vetëm 2.7 për qind ndërsa megjithatë 64.1 për qind janë me arsim sipëror.

## VMRO: Qeveria zhvillon politika ekonomike rrënuese

Shkup, 11 mars - Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, në seancën e Komitetit Qendror të partisë të shtunën mbrëma ka paralajmëruar se në periudhën e ardhshme do të fillojë takimet në terren me qytetarët në mbarë vendin, me qëllim që t'i dëgjojë sugjerimet e tyre që pastaj për ato të ofrohen zgjidhje programore. Ai dhe anëtarët e Komitetit Qendror kanë vlerësuar se në planin ekonomik vendi po fundoset dhe po ballafaqohet me kolaps dhe se pas nëntë muajve qeverisje, qytetarët janë "dëshmitarë të dhjetëra gënjeshtreve dhe premtimeve të papërbushura nga periudha parazgjedhore". "Me çdo ditë të kaluar konfirmohen dyshimet se funksionarët e LSDM-së ose me vetëdije i kanë gënjer qytetarët ose tërësisht janë të paafhtë të realizojnë atë që e kanë premtuar gjatë fushatës. Katastrofa është e njëjtë edhe në nivel lokal edhe në nivel qendror", ka thënë Mickovski në seancën e Komitetit Qendror. Lidhur me gjendjen ekonomike, anëtarët e KQ-së kanë konkluduar se "paaftësia e LSDM-së po reflektohet me rezultate katastrofale në kurriz të qytetarëve". Prej atje thonë edhe se sundimi i së drejtës është rrezikuar dhe aspak nuk përmirësohet gjendja me sistemin gjyqësor. Në seancën e Komitetit Qendror, Zllatko Perinski është emëruar shëf i kabinetit i Mickoskit, me çka u ndërpre mandati i tij i deritanishëm si anëtar i Komiteti Ekzekutiv të partisë.



## Qoses i hiqet edhe bazamenti

Shkup, 11 mars - Para Gjykatës Supreme në Shkup, të dielën është hequr edhe bazamenti në të cilin para pak kohësh qëndronte përmendorja e Andon Janev - Qoses, i cili u hoq natën midis 21 dhe 22 shkurtit dhe u çua në magazinat e Entit metalurgjik-Tito. Urdhri për heqjen e monumentit e lëshoi Inspektori Ndërtimor i Komunës së Qendrës pas inspektimit dhe gjendjes faktike të vërtuar se nuk ka pasur vendim për vendosjen e kësaj përmendoreje. Statuja e Qoses në këtë lokacion qëndronte nga shtatori i vitit 2014, si donacion i Shoqatës për bashkim shpirtëror të Setinëve, Popadinëve dhe Kruhoradëve nga Follorina. Grupi i punës në Ministrinë e Kulturës, paraprakisht ka konstatuar një sërë shkeljesh ligjore gjatë vendosjes së këtij busti. Kryebashkiaku i Shkupit, Petre Shilegov, njoftoi muajin e kaluar se në vendin e monumentit do të mbillet pema e drejtësisë.

## STRUKTURA E MOSHËS NË SEKTORIN PUBLIK

# ADMINISTRATOR 45 VJEÇ



Një e treta apo afër 30 për qind e numrit të përgjithshëm të administratës janë të moshës 46 deri 55 vjeç, të moshës 56 deri 64 vjeç janë 21.4 për qind, pason grupmosha prej 36-45 vjeç me 25 për qind, si dhe grupmosha 26 deri 35 vjet me afër 21 për qind të totalit të punësuarve në sektorin publik

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 mars - Moshë mesatare e të punësuarve në sektorin publik në Maqedoni është 45 vjeç.

Një e treta apo afër 30 për qind e numrit të përgjithshëm të administratës janë të moshës 46 deri 55 vjeç, të moshës 56 deri 64 vjeç janë 21.4 për qind, pason grupmosha prej 36-45 vjeç me 25 për qind, si dhe grupmosha 26 deri 35 vjet me afër 21 për qind të totalit të punësuarve në sektorin publik. Nga ana tjetër, në numër më të vogël janë të përfaqësuar grupmoshat më të reja prej 18 deri 25 vjeç (2 për qind) dhe më të moshuar mbi 64 vjeç (0.52 për qind), tregojnë analizat e Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë për vitin 2016.

Analiza më tej tregon se moshë mesatare në ndërmarrjet publike është 48.39 vjet, në komunat është 44.5 vjet, në ministri është 42.5 vjet, në gjyqë është 45.5 vjet dhe në nivel të qeverisë është 36 vjet. Moshë mesatare më e re vërehet tek Sekretariatet e Qeverisë si rrjedhojë e moshës më të re të të punësuarve në Sekretariatet për realizimin e Marrëveshjes së Ohrit.

Në analizën e moshës nuk përfshihen të punësuarit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të atë të Mbrojtjes.

"Në sektorin publik në Maqedoni janë aktive 1291 institucione, në të cilat

marrëdhënie pune kanë lidhur 129.653 persona. Prej tyre, 19.342 persona janë të punësuar në Armatë, Agjencinë për Zbulim, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe organet në përbërje të saj me status të personave të autorizuar për të cilat në regjistr mbahen të dhëna vetëm për numrin, por jo edhe për strukturën e tyre", theksohet ndër të tjerash në raportin vjetor për vitin 2016.

Andaj, në raportin vjetor për vitin 2016 është analizuar vetëm struktura e të dhënave për 110.311 të punësuar në sektorin publik, prej të cilave 59.111 janë gra, ndërsa 51.200 janë burra. Moshë mesatare e këtyre të punësuarve është 45.43 vjet. Mesatarja e moshës së grave të punësuar është 44.72 vjeç, ndërsa tek burrat është 46.25 vjeç. Nëntë të punësuar janë të moshës 19 vjeçare, ndërsa 21 të punësuar janë të moshës 67 vjeç.

Nga të gjithë të punësuarit, pa arsim janë 485 persona, 270 janë me gjysmë kualifikim, 412 janë të kualifikuar, 9236 janë me arsim fillor, 36.310 janë me arsim të mesëm, 4883 janë me kualifikim të lartë, 6515 janë me arsim të lartë, 48.322 janë me fakultet, 2107 janë magjistra dhe 1771 janë doktorë.

Sa i përket strukturës etnike të administratës, 82.900 janë maqedonas, 21.279 janë shqiptarë, 1781 janë turq, 1272 janë serb, 1215 janë romë, 479 janë boshnjakë 478 janë vllleh dhe 907 të punësuar janë të tjerë ose nuk janë deklaruar.

Numri më i madh i institucioneve apo 769 prej tyre janë nën kompetencat e komunave, ndërsa 522 institucione janë nën kompetencat e pushtetit qendror. Nga 1291 institucione në nivel shtetëror, pjesa më e madhe janë institucionet arsimore. Me fjalë të tjera, institucionet e ndryshme

arsimore janë 538 që paraqet 41.67 për qind të institucioneve në tërë sektorin publik. Në kuadër të institucioneve të arsimit, dominojnë shkollat fillore me 353, pasojnë

107 shkolla të mesme, 57 fakultete dhe institucione të tjera të arsimit të lartë, 16 konvikte, etj. Në Maqedoni funksionojnë 129 ndërmarrje publike, prej të cilave 109 janë ndërmarrje për punë komunale, 8 për bujqësi dhe pylltari, 7 të transportit etj. Në arsim janë të punësuar 34.708 persona, në shëndetësi 19.991 persona, në punë dhe sociale 605 persona, në kulturë janë të punësuar 3237 persona etj. Në institucionet gjyqësore janë të punësuar 2893 persona. Prej tyre, 2384 janë të angazhuar në gjyqë, ndërsa 457 në prokuroritë publike.

Në ndërmarrjet publike janë të punësuar 17.872 persona të shpërndarë në tre grupe - edhe atë nëpunës administrativ (publik), ofrues të shërbimeve publike dhe persona ndihmës-teknik. Më së shumti të punësuar ka në ndërmarrjet e punëve komunale apo 10.065, pason transporti me 4188 të punësuar, bujqësia dhe pylltaria me 2551 të punësuar etj. Nga ana tjetër, në 85 komuna janë të punësuar 5677 persona.

Ven të theksohet se në veprimtaritë e bujqësisë, pylltarisë, Radio Televizionit të Maqedonisë dhe Radiodifuzionit të Maqedonisë, mbi 30 për qind e të punësuarve

janë të moshës 56 deri 64 vjeç. Nga ana tjetër, moshë më të re sipas institucioneve me 29 vjet - ka shkolla e mesme e Sarajit dhe "Marnet", apo rrjeti hulumtues akademik. Nga institucionet me më shumë se 100 të punësuar, moshë më të re të të punësuarve me 32.94 vjeç ka Sekretariati për realizimin e Marrëveshjes së Ohrit, shkolla e mesme e muzikës në Tetovë me 34 vjeç dhe Sekretariati për çështje evropiane me 35 vjeç. Nga institucionet me më shumë se 100 të punësuar, moshë më të madhe mesatare të të punësuarve me 52.71 vjet ka ndërmarrja publike "Infrastruktura e Maqedonisë", pason Shtëpia e Shëndetit në Manastir me afër 52 vjeç dhe ndërmarrja komunale në Gostivar - afër 51 vjeç.

**Nga të gjithë të punësuarit, pa arsim janë 485 persona, 270 janë me gjysmë kualifikim, 412 janë të kualifikuar, 9236 janë me arsim fillor, 36.310 janë me arsim të mesëm, 4883 janë me kualifikim të lartë, 6515 janë me arsim të lartë, 48.322 janë me fakultet, 2107 janë magjistra dhe 1771 janë doktorë**

FOTOGRAFITË DHE POSTIMET NË RRJETET SOCIALE DËSHMI NË PROCEDURAT GJYQËSORE

# ZBULOHEN KËRCËNUESIT E ZAEVIT

MPB punon në mbi tridhjetë raste ku përmes rrjeteve sociale bartësit e funksioneve publike në Maqedoni ju kërcënohet jeta si dhe raste ku janë keqpërdorur të dhënat e tyre personale. Gjashtë prej këtyre rasteve ka të bëjë me kanosjet drejtuar kryeministrit Zaev

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 11 mars - Fotografitë dhe postimet që do të publikohen në rrjetet sociale do të mund të shfrytëzohen si dëshmi në procedurat gjyqësore në Maqedoni. Gjithë dëshmitë që do të merren në mënyrë ligjore - do të mund të nxirren para gjykatës dhe mbi ato do të merren vendime gjyqësore. Kërcënimet drejtuar kryeministrit Zaev, siç informojnë nga MPB, nga muaji i kaluar është tashmë një tjetër vepër penale për të cilën Sektori për krim kompjuterik pranë MPB ka përgatitur edhe raport deri tek Prokuroria Publike. MPB punon në mbi tridhjetë raste ku përmes rrjeteve sociale bartësit e funksioneve pu-



blike në Maqedoni ju kërcënohet jeta si dhe raste ku janë keqpërdorur të dhënat e tyre personale. Gjashtë prej këtyre rasteve ka të bëjë me kanosjet drejtuar kryeministrit Zaev.

Nga MPB theksojnë se tashmë është zbuluar personi që ka kërcënuar kryeministrin Zaev dhe ka cenuar jetën e tij përmes Facebook edhe atë në koordinim me Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, me rrjetin social "Facebook", si dhe me Interpolin e Zvicrës dhe një internet provajder nga i njëjti shtet. Pas dokumentimit të plot të rastit kundër të dyshuarit do të parashtrahet kallëzim penal në kompetencë të Prokurorisë Publike.

Ministria e Brendshme gjithashtu informon se në të njëjtën mënyrë veprojnë mbi të gjitha kërkesat e paraqitura për kërcënime për rrezikimin e sigurisë të të gjithë qytetarëve. Nga Prokuro-

ria Publike e Maqedonisë konfirmuan se screenshotet, si dhe postet e rrjeteve sociale, mund të përdoren në procedurat gjyqësore, nëse ato janë marrë në mënyrë të ligjshme. Publikimet monitorohen dhe analizohen dhe nëse Prokuroria Publike përcakton se ka elementë të një vepre penale do të reagojë sipas detyrës zyrtare. Në praktikën e deritanishme në Maqedoni ka pasur raste ku fotografitë "screenshot" dhe statuset në rrjetet sociale janë përdorur si dëshmi në procedurat penale.

Kështu, vitin e kaluar, Gjykata Penale në Shkup e shpall fajtor E.A. për shkak të një fyerje ndaj presidentit turk Rexhep Taip Erdogan në Facebook. Gjykata dënoi EA, me shtetësi maqedonase dhe turke, me një gjobë prej 24,600 denarësh (400 euro) në procesin që u hap pas një padie penale nga ambasadori turk në

vend, Tulin Erkal Kara. Pas vendimit të Gjykatës u deklarua se në nëntor të vitit 2016, i pandehuri "botoi deklarata ironike dhe dërgoi fyerje drejtuesit të një vendi të huaj përmes profilit të tij në Facebook". Nëse E.A. nuk paguan gjobë, ai do të duhet të vuajë dënimin me burg.

Nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë gjithashtu tregojnë për rastin që zyra e prokurorit merret me publikimin e një rrjeti social në të cilin përdoret një fjalë vulgare për pjesëtarët e minoritetit rom. Sa i përket fyerjes, PPRM thekson se kjo është e rregulluar me Ligjin për përgjegjësinë civile për ofendim dhe shpifje dhe nuk bën pjesë në krime që ndiqen penalisht. Prandaj, Prokuroria Publike, në pajtim me rregulloret ligjore, nuk ka kompetencë të veprojë në rastet kur ka një ofendim apo shpifje.

## KRONIKË

### Rrëzohet nga elavatori, punonjësi i TAV-it thyen brinjët

Supervizori i TAV-it mori lëndime serioze, duke zbritur nga elevatori gjatë kohës që ishte në punë, tha policia. Në 13:52, të shtunën, nga Klinika e Sëmundjeve Kirurgjikale "Shën Naumi i Ohrit" në Shkup, u raportua se është sjellë një i dëmtuar J.N. (57) nga Shkupi, i cili ishte i punësuar si mbikëqyrës në njësinë për pranimin dhe dërgimin e avionëve në TAV. Ai shpjegoi se po të njëjtën ditë, rreth orës 13, gjatë kryerjes së detyrave të tij, duke zbritur nga elevatori, ai rrëshqiti dhe ra nga një lartësi prej 1.5 metrash dhe si pasojë pati pati krisje të brinjëve.

### Postieri kafshohet nga qeni

Një postier u kafshua nga një qen në fshatin Trubarevë gjatë kryerjes së detyrave të tij të punës. "N.U. (41) nga Shkupi njoftoi të shtunën se rreth orës 10:30 në rrugën "1" në fshatin Trubarevë u kafshua nga një qen në pjesën e pulpës së majtë të këmbës gjatë kryerjes së detyrave si postier i punësuar në SHA "Posta e Maqedonisë"2, njoftoi policia.

### Alkool ilegal në një firmë në Kavadar, arrestohet drejtori

Mbi 9000 shishe alkool të paketuara në një sasi prej 0.7 litrash ose litërsh, të cilat nuk kanë një pullë akcize, u zbuluan tek një person juridik në Kavadar dhe menaxheri është privuar nga liria për tu hetuar dhe grumbulluar informacion në lidhje me mallin e gjetur. Alkooli u gjet gjatë aksionit të djeshëm të Prokurorisë Publike të Kavadarit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. "Aksioni vazhdon edhe në kantinën "Povardarie", ku sipas të dhënave paraprake, u gjet një sasi e madhe e rakisë së verdhë, pa etiketat me banderola, me shënime për shitje përmes kompanisë "Vino Zhupa" nga Republika e Serbisë, që e ka nën zotërim edhe "Povardarie" Negotinë", njoftoi Prokuroria Publike e Maqedonisë. Prokurori kompetent publik nga Prokuroria Publike e Kavadarit lëshoi udhëzime dhe urdhra për mbledhjen e të dhënave dhe dokumentacionin e nevojshëm në këtë rast. Veprime të tjera janë ndërmarrë për të vërtetuar faktet. (O.Xh)

## Simonovski nxori sekret shtetëror, i merret pasaporta

Shkup, 11 mars - Daragan Simonovski, këshilltarit në kabinetin e Ministrisë të Punëve të Brendshme i është shqiptuar padi penale dhe do të mbrohet në gjendje të lirë për "abuzim të pozitës zyrtare dhe autorizimit", por për hir të masave të sigurisë, i është marrë përkohësisht pasaporta dhe është i detyruar të paraqitet para autoritetit kompetent, vendosi gjykata. Këshilltari në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili u arrestua pardje në stacionin policor akuzohet për nxjerrjen e një sekreti shtetëror me të cilin e ka rrezikuar dhe e ka dëmtuar hetimin penal që është një vepër e ndëshkueshme me ligj. Dje, Ministria e Punëve të Brendshme njoftoi se Simonovski, i cili ishte ekspert të fushës e kriminalistikës dhe këshilltar shtetëror në kabinetin e ministrit për kriminalistikë, më 26 shkurt në mjediset e një institucioni shëndetësor në Shkup ka pa-



sur takim me një femër, ndaj të cilës po zbatoheshin masa të veçanta hetimore. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, Simonovski ka nxjerrë një sekret zyrtar, duke i treguar se ndaj saj është duke u zbatuar një masë e veçantë hetimore dhe se po përgjohen të gjithë numrat e saj telefonikë dhe

se një masë monitorimi zbatohet ndaj saj. Ai e paralajmëroi atë të ishte e kujdesshëm dhe se në ditët e ardhshme mund të aplikohet një masë e re - duke përdorur një agjent të infiltuar. Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, të shtunën në një konferencë shtypi tha se pret që

shumë shpejt në një procedurë të përcaktuar me ligj dyshimi të konfirmohet ose refuzohet. Theksoi se MPB-ja nuk do të tolerojë rrezikimin e hetimeve dhe procedurave. "Nxjerrja e një sekreti zyrtar, rrezikimi dhe dëmtimi i një hetimi penal, është vepër penale. Qytetarët na kanë dhënë besimin për të luftuar krimin dhe për çdo aktivitet të paligjshëm të konfirmuar do të ketë zero tolerancë. Duhet të jetë e qartë për të gjithë", tha Spasovski. Lidhur me këtë rast reagoi edhe kryeministri Zoran Zaev i cili në rrjetin social "Facebook" shkruan se nuk i di detajet për rastin por i motivon institucionet të realizojnë hetim profesional dhe të sjellin vendime të bazuara në fakte. "Institucionet duhet që të jenë në shërbim të qytetarëve dhe në funksion të sundimit të së drejtës. Nuk ka vend për tolerancë për veprimet e jashtëligjshme", shkruan Zaev. (O.Xh)



## LSDM i dënon sulmet ndaj Selmanit

Shkup, 11 mars - Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë dënon çdo lloj të gjuhës së urrejtjes, fyerjes apo nënçmimit ndaj çdo qytetari të Republikës së Maqedonisë. "LSDM-ja i dënon sulmet ndaj gazetarëve dhe sulmet ndaj kryetarit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani. Gazetarët kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe avancimin e proceseve demokratike dhe nga kjo sulmi ndaj gazetarëve është sulm ndaj lirisë së shprehjes dhe vlerave demokratike", thonë nga LSDM-ja. Personat publik duhet të jenë të kujdesshëm në sjelljen e tyre dhe paraqitjet publike dhe ta kenë parasysh se nga ajo si sillen personat publik varet edhe mendimi i qytetarëve për ato, sipas kësaj i vlerësojnë edhe çmojnë.

## Rrihen për një vajzë, dy të mitur përfundojnë në spital

Shkup, 11 mars - Në polici janë paraqitur dy raste të ndara në të cilat si kryerës paraqiten persona minoren, ndërsa ngjarjet kanë ndodhur në afërsi të shkollave. Janë lënduar dy persona, njëri është goditur me thikë, ndërsa tjetri ka marrë lëndime në fytyrë. Të shtunën mbrëma në orën 19:17 nga Klinika për Sëmundje Kirurgjike "Sh Nuami i Ohrit" është paraqitur se te ato është sjellë i lënduar A.B (18) nga fshati Bllacë, me goditje thike në pjesën e këmbës nga ana e një personi të panjohur para shkollës në Shuto Orizarë. Si arsye theksohet zënka paraprake për një vajzë. Një i punësuar në shkollën e mesme "Arseni Jovkov" dje në orën 17:10 ka paraqitur se në rrugën "Kosturska" jashtë nga oborri i shkollës fizikisht është sulmuar një nxënës 16-të vjeçar nga fshati Studeniçan i Shkupit. Pas masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, në stacionin policorë është marrë në bisedë një 16-të vjeçar i cili është kryerës i mundur i veprës. Ndërmerren masa për gjetjen edhe të personave tjerë minoren pas çka do të parashtrahet paditë përkatëse.

## LISTAT E PROPOZUARA NGA MASH-I ME VËREJTJE PËR TITUJ TË CAKTUAR



Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 11 mars - Vërejtjet e para, megjithëse jo zyrtare për propozim-listat e lekturave të shkollave fillore, kanë të bëjnë kryesisht me prezencën e shumë titujve të vjetër në ato që pretendojnë të kthehen në lista të reja të cilat do të përdoren nga viti i ardhshëm shkollor. Lektura si "Zoki Poki", "Lepuri me pesë këmbë", "Oliver Tuisti", "Aventurat e Tom Soerit" e të ngjashme, për dekada me radhë nuk u shqiten listave të lekturave që lexohen nga nxënësit e arsimit fillor në kuadër të realizimit të programeve mësimore. Sipas profesorëve të gjuhës dhe letërsisë, ka tituj dhe autorë të cilët mund të qëndrojnë nëpër këto lista, por jo të gjithë e meritojnë "përkatësinë" pasi shumë lektura të cilat nuk kanë zgjuar interesimin e nxënësve deri tani nuk mund të presim që të bëhen interesante në të ardhmen.

"Ne po presim që listat e lekturave të ndryshojnë cilësisht, mirëpo mesa arrita të shoh nuk kishte

Emine Ramuka nga shkolla fillore "Imri Elezi" në Shkup, thotë se arsimtarët e gjuhës dhe letërsisë shqipe presim që listat e lekturave të ndryshojnë cilësisht

ndonjë ndryshim domethënës. Kryesisht nëpër listat sillen po ato lektura të cilat janë punuar edhe më herët" pohon Emine Ramuka, arsimtare e gjuhës dhe letërsisë shqipe në SHF "Imri Elezi" në Shkup. Sipas saj, nxënësve duhet t'u ofrohen lektura më atraktive dhe nëse nuk i posedojmë në gjuhën shqipe dhe maqedonishte le të mendohet dhe mundësia e përkthimit të librave. Sot të gjithë nxënësit janë përdorues të teknologjisë informatike. Kjo teknologji, sipas saj mund të shfrytëzohet

shumë mirë edhe në kontekstin e leximit të lekturave. "Me nxënësit e mi praktikoj edhe formën e leximit të lekturave dhe gjeten e materialeve në internet. Është një formë e cila funksionin për mrekulli", tregon Ramuka. Por, padyshim se çështja kryesore ka të bëjë me tematikën që kanë lekturat dhe romanet që kërkojmë të lexojnë nxënësit. Për këtë, listat duhet të rinovohen krejtësisht, vëren ajo. Këtë mendim ndajnë edhe profesorët universitar. "Ka lektura si 'Lepuri me pesë këmbë' për shembull të cilat janë lexuar në kohën e timi, i kam lexuar unë, fëmijët e mi dhe tani duhet ti lexojnë nipërit dhe mbesat. Kjo nuk më duket në rregull aspak", shprehet prof. dr. Avzi Mustafa. Sipas tij, për gjeneratat e reja të nxënësve nuk provokon asnjë interes as lektura "Zoki Poki", e cila bashkë me shumë të tjera nuk duhet të qëndrojnë në listat e reja të lekturave shkollore. Thjeshtë, sepse trajton ngjarje nga koha e luftës së parë botërore, sqaron Mustafa. Ndërkaq, zëvendë-

ministri i Arsimit, Arbër Ademi, thotë se lista nuk janë përfundimtare. Të gjithë mësimdhënësit e kësaj lënde e jo vetëm, kanë mundësi të dërgojnë vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e tyre. "Ne në MASH, do të trajtojmë me seriozitet çdo vërejtje që do të na vjen për titujt e lekturave dhe do të marrim në konsideratë çdo propozim të ri i cili do të na vjen enkas me listat e reja të lekturave", deklaroi zëvendësiministri Ademi.

Propozim-listat në fjalë, sikurse dihet janë përgatitur nga komisioni të posaçme që kishte formuar për këtë çështje Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) tre vite më parë. Në fillim të 2017 propozim lista për lektura në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke, i ishin dërguar MASH-it por të njëjtat u morën në shqyrtim nga MASH vetëm në fillim të këtij viti. Më 26 shkurt MASH publikoi ato propozim-lista të cilat do të jenë në fazën e debatit publik që do të zgjat deri në datën 26 të këtij muaji.

## Së shpejti dihet si do të financohet Qendra e re Klinike

Shtip, 11 mars - Në zhvillim janë negociatat me kreditorët dhe së shpejti do të bëhet e ditur se si do të financohet ndërtimi i Qendrës Klinike - Shkup në lokacionin e ri pranë spitalit të Bardovcit. Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, shprehet i sigurt se Qendra Klinike moderne nuk mund të ndërtohet në lokacionin ekzistues. "Ajo që duhet të fitohet është një bllok i ri i ndërtesës, i cili duhet të bashkohet me dy ndërtesa, të cilat tashmë janë gati për rinovim, duke përfshirë edhe ndërtesën e re të Gjinologjisë, të cilës vetëm pas disa viteve të funksionimit duhet t'i rinovohet çatia sepse lëshon ujën.



Përveç kësaj, në suaza të këtij kompleksi mbeten edhe shtatë ndërtesa të vjetra, të cilat assesi nuk kanë hyrë në projekt. Në këtë moment ata janë në një gjendje aq të keqe

sa që tashmë kërkohet ndonjë formë e rikonstruimit. Nëse hyjmë në këtë projekt, pavarësisht nga shumica për të cilën bëhet fjalë si investim, do të hyjmë në një cikël

nga i cili nuk do të mund të dilnim", tha Filipçe, i cili të dielën mori pjesë në përkujtimin e deportimit të hebrenjve nga Shtipi. Ai theksoi se me ndërtimin e Qendrës të re Klinike në lokacionin ekzistues, nuk do të fitohet qendër e re moderne dhe pacientë, tha se edhe mëtej do të duhet të transportoheshin nëpër rrugë. Ndërtimi në lokacionin e ri do të sigurojë një koncept të ri të ndërtesës moderne spitalore në të cilën pacientët do të kenë shërbime mjekësore të integruara, si në vendet tjera evropiane. Për ndërtimin e Spitalit të ri Klinik- Shtip tha se është me dinamikë të vonuar për shkak kushteve të motit.

## STAZHI I BENEFICUAR

# PËRFITIME PËR PROFESIONET E RREZIKSHME

Do të rishqyrtohen edhe kërkesat e profesioneve që mund ti nënshtrohen stazhit të beneficuar, ndërsa do të mundësohet pensionimi i afër 41 mijë punëtorëve nga profesionet me rrezik që kanë ndërprerje në stazhin e beneficuar

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 mars - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është në përgatitje e sipër të ndryshimeve ligjore që përgjatë këtij viti do të mundësojë pensionimin e afër 41 mijë punëtorëve nga profesionet me rrezik që kanë ndërprerje në stazhin e beneficuar. Qëllimi është që përvoja e punës apo stazhi i beneficuar të përlogaritet në bazë të moshës dhe kohës së kaluar në vendin e rrezikshëm të punës, thonë nga ky dikaster.

Ndryshimet ligjore parashikojnë pensionim para kohe nëse i punësuar i ka mbushur 50 vjet, ndërsa ka kaluar 80 për qind të përvojës së punës në vend të rrezikshëm të punës. Në këtë frymë do të fillojë me punë edhe komisioni që do të shqyrtojë kërkesat e profesioneve që mund ti nënshtrohen stazhit të beneficuar si dhe do të përgatitet regjistri i profesioneve të rrezikshme me ngarkesë të ndryshme ku do të vendosen profesionet që do të shkojnë në

pension të parakohshëm për të cilat vendosen masa të veçanta të mbrojtjes.

Reforma në këtë drejtim parashikon që të zgjidhë problemin ekzistues me plotësimin e kushteve për pensionimi të parakohshëm, gjegjësisht me revizionin e vendeve të tanishme të punës që hyjnë në kategorinë e stazhit të beneficuar, si dhe përcaktimin e kriterëve për masat mbrojtëse dhe vendosjen e konceptit për pensionim të parakohshëm për këto profesione.

## CILAT PUNË DO TË KONSIDEROHEN TË BENIFICUARA?

Neni 1 i Rregullores për përcaktimin e vendeve të punës të cilave stazhi ju llogaritet me kohë të zgjatur, përcakton se cilat janë ato pozita pune që llogariten me stazh të beneficuar.

"Në ato raste ku vendi i punës është sidomos i vështirë dhe ndikon në mënyrë të dëmshme ndaj gjendjes shëndetësore dhe aftësisë punuese të punëtorit, edhe përkundër asaj se janë zbatuar të gjitha masat mbrojtëse të

përcaktuara me ligj si dhe masat e tjera që ndikojnë në uljen apo evitim të ndikimeve të dëmshme", theksohet më tej në Rregullore që përcakton edhe atë se cilat profesione llogariten 14, 15, 16, 17 dhe muaj të sigurimit për çdo 12 muaj stazh të punës efektive, në varësi se sa është e rëndë dhe i dëmshëm vendi përkatës i punës.

Aktualisht në Maqedoni ka 28.451 punëtorë të siguruar me përvojë pune të pandërprerë të beneficuar, dhe afër 41 mijë të tjerë që kanë punuar në vende të rrezikshme por me ndërprerje në përvojën e punës. Sipas dispozitave ligjore, përvojë pune të beneficuar fitojnë personat kur punëdhënësi ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje, por megjithatë ato shkaktojnë rrezik për shëndetin (xehetarët, punëtorët në furrat e lata) për shkak të zvogëlimit të funksioneve fiziologjike të organizmit nuk mund të kryejnë angazhimet e tyre në vendin e punës. Stazh të tillë të privilegjuar gëzojnë edhe balerinat, pilotët, pjesëtarët e policisë dhe armatës, zjarrfikësit, varrmihësit,

këngëtarët, barinjët, vozitësit e autobusit dhe trenit, personeli i ndihmës së shpejtë, që kanë mundësi të punojnë një vjet, ndërsa stazhi i punës t'ju llogaritet në mënyrë shtesë prej dy deri gjashtë muaj plus. Për punëtorët e ndërtimeve ekziston përvojë pune e beneficuar, por vetëm nëse punojnë në hapjen e tuneleve.

## STATUSI I DISA PROFESIONEVE-I PAZGJIDHUR

Në qarqet sindikale vlerësohet se në listën e punëtorëve që punojnë me stazh të beneficuar nuk përfshihen të gjitha vendet e punës që e meritojnë diçka të tillë në sajë të kushteve të rënda të punës. Akoma mbetet i pazgjidhur statusi i disa profesioneve ndër të cilat janë edhe më shumë se 20 vende pune në ndërtimtarë që akoma nuk kanë stazh të privilegjuar të punës. Gjithashtu edhe mësuesit akoma dalin në pension me 62 vjet për gratë, dhe 64 për burrat, edhe pse bëjnë pjesë në një ndër profesionet me më shumë lodhje dhe stres për shkak se një kohë të gjatë punojnë me fëmijë.

## NË SERBI, EDHE "FRIZERËT" ME STAZH TË BENIFICUAR!

Enti Shtetëror i Serbisë ka përcaktuar se nga 110 mijë punëtorë të punësuar në institucionet shtetërore që gëzojnë përvojë pune të beneficuar, 65 mijë prej tyre e kanë realizuar këtë benefit në bazë të kriterëve të dyshimta. Vetëm për shkak se janë të punësuar në Ministrinë e Brendshme dhe të Mbrojtjes, në organet Tatimore, entet e ndryshme, si punonjës

administrativ, teknik, të sportelit apo si komercialist, kanë realizuar të drejtën në përvojë pune të privilegjuar, ngjashëm si kolegët e tyre- polic, ushtarë, anëtarë të njësisve speciale e kështu me radhë. Si rrjedhojë e zbatimit të kësaj të drejte të stazhit të beneficuar, ndër të privilegjuarit janë gjendur edhe ondulistët apo frizerët, molerët, muzikantët.



## Angjushev: Është koha për investime

Kumanovë, 11 mars - Me masat e parapara në Planin qeveritar për rritje ekonomike, biznesmenët duhet ta dinë se është koha për investime, theksoi zëvendëskryeministri i Çështjeve Ekonomike, Koço Angjushev në takimim me afaristët e Kumanovës. Sipas Angjushevit, para në Buxhet për ndihmën e biznesit janë përcaktuar, është bërë program për mbështetjen e kompanive, ndërsa një pjesë do të shndërrohet në ligj. Plani, siç theksoi, parashikon mbështetje për të gjitha kompanitë, ka shumë masa, janë të qasshme në ueb faqet e institucioneve zyrtare qeveritare, aplikimi do të jetë i thjeshtë, firmat do të duhet të dorëzojnë llogari përfundimtare, ndërsa ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të përshkruajnë biznes plan të shkurtër. Biznesmenët e Kumanovës kërkuar ndryshim të rregullores ligjore për të cilën theksuan se në pjesë të caktuara është vjetërsuar, ndërsa si shembull e theksuan Ligjin për dogana. Kërkuar edhe ndryshim të subvencioneve gjatë punësimit të përmasave aktuale të më shumë kategorive të personave të papunë. U duhet mbështetje nga Qeveria edhe për rritjen e grejs-periodhës për kthimin e kredive, me qëllim të investimeve të reja dhe më shumë punësime, mbështetje gjatë eksportit, por edhe infrastrukturë më të mirë. Zëvendëskryeministri u përgjigj se ligje të caktuara janë vjetërsuar dhe mbrojnë industri të caktuara të cilat tashmë nuk punojnë, dhe siç paralajmëroi, do të tentojnë të veprojnë përmes ndryshimit të ligjit.

## Lavdërohet Qeveria: Po kthehet besimi në ekonominë vendore

Shkup, 11 mars - Qeveria vlerësoi se të dhënat e publikuara statistikore për rritjen e BPV-së, të punësimit në prodhimtarinë industriale janë dëshmi për stabilizim ekonomik dhe kthimin e besimit të humbur në perspektivat e ekonomisë vendore. "Të dhënat e publikuara të Entit Shtetëror për Statistikë (ESHS) për bruto

prodhimin vendor (BPV) për vitin e fundit tregon se në tremujorin e katërt të vitit 2017 ekonomia shënon rritje prej 1.2 për qind dhe del nga situata e stagnimit. Kjo është dëshmi se po kthehet besimi i humbur në perspektivat e ekonomisë vendore", theksojnë nga Qeveria e RM-s. Në mënyrë shtesë, theksohet në kumtesën e

shërbimit qeveritar për media, të dhënat e fundit të publikuara nga ESHS tregojnë edhe rritje të prodhimtarisë industriale prej tetë për qind që paraqet edhe një konfirmim se aktiviteti ekonomik po intensifikohet. "Gjendjen faktike të cilën e trashëgoi Qeveria pas formimit të saj ishte rënia e ekonomisë prej 1.3 për qind për

shkak të krizës së vështirë politike të shkakuar nga bllokimet politike, por edhe për shkak të menaxhimit të papërgjegjshëm me ekonominë në vitet e fundit. Politikat e reja ekonomike, proceset reformuese, riafirmimi i proceseve integruese të Republikës së Maqedonisë në BE dhe në NATO kontribuuan që ekono-

mia të stabilizohet dhe të fillojë të shënojë norma të rritjes të BPV-së", theksohet në kumtesën e Qeverisë. Stabilizimi ekonomik sipas Qeverisë, konfirmohet edhe më të dhënat për rritje vjetore të punësimit prej 1.9 për qind në tremujorin e katërt në vitin 2017, krahasuar me tremujorin e njëjtë nga viti 2016.





TETOVA NË PRITJE TË MARRËVESHJES



# OPTIMIZËM PËR

# MARRËVESHJEN E KËSHILLIN

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 11 mars - Në fund të muajit mars, kur edhe është afati i fundit për formimin e shumicës në Këshillat e komunave, pritet të përfundojë ngërçi edhe në Këshillin e Komunës së Tetovës. Pas zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar, Komuna e Tetovës vazhdon të funksionojë pa Këshillin komunal, respektivisht pa krijimin e shumicës. Kryetarja e Komunës, Teuta Arifi, megjithatë shpreson se deri në fund të muajit do të ketë marrëveshje, pa dhënë detaje se me cilin apo cilët subjekte do të krijohet kjo shumicë. "Në fund të muajit mars presim të arrijmë marrëveshje për krijimin e shumicës në Këshillin e Komunës së Tetovës. Edhe njëherë po e them se atmosfera në të cilën zhvillohet ky proces është konstruktive dhe në fund të muajit mars të fillojë të funksionojë Këshilli normalisht. Siç e dini, Këshilli ka mbajtur seanca ku ato janë udhëhequr nga kryesuesi më i moshuar dhe besoj se do të arrijmë të zgjidhim edhe këtë problem", deklaroi Arifi.

Burime në BDI-në e Tetovës thonë se është autorizuar kryetarja Arifi që të zhvillojë negociata dhe në këtë drejtim, shpresat janë që të arrihet marrëveshje, megjithatë kontesti mbetet tek posti i kryetarit të Këshillit, për të cilin kanë pretendime edhe partitë opozitare

laroi Arifi. Lidhur me mosmbajtjen e seancës solemne për shënimin e Ditës së Komunës së Tetovës, Arifi tha se seanca e tillë solemne është e udhës që të udhëhiqet nga ana e kryetarit të zgjedhur, kurse për raste të jashtëzakonshme - seancën mund ta udhëheq edhe kryesuesi

më i vjetër. "Mendojmë se është më mirë që një mbledhje solemne të udhëhiqet nga kryetar i zgjedhur, kurse në raste tjera kur ka pika urgjente, tema urgjente... faktikisht seancat mund të udhëhiqen edhe nga ana e kryesuesit më të vjetër, kurse kur bëhet fjalë për solemnitet, atëherë ato edhe mund të presin derisa nuk mund të zgjidhen çështjet e tjera", tha Arifi. Sipas burimeve brenda kampit të këshilltarëve të BDI-së, janë duke u zhvilluar negociata intensive për të arritur një marrëveshje për krijimin e një shumicë në Këshillin e Komunës së Tetovës. Sipas këtyre burimeve, BDI e ka autorizuar kryetaren Arifi që të zhvillojë negociata dhe në këtë drejtim, shpresat janë që të arrihet marrëveshje, megjithatë kontesti mbetet tek posti i kryetarit të Këshillit, për të cilin kanë pretendime edhe partitë opozitare. Po ashtu, nga BDI thonë se bisedimet nuk kanë të bëjnë me ndonjë koalicionim të mundshëm në nivel qendror, por vetëm në nivel lokal. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që të

shkohet në zgjedhje të reja për Këshillin e Komunës së Tetovës, nëse deri më 31 mars nuk arrihet marrëveshje. Fillimisht kishte një përpjekje që të krijohet shumicë, kur kryetar Këshilli u zgjodh, Adnan Bilalli nga PDSH, por më pas u konstatua se zgjedhja e tij nuk ishte legjitime. Përndryshe, me vendim të Qeverisë, për të mos u bllokuar puna në komunë, Ministria e Financave e ka pranuar Buxhetin e Komunës së Tetovës, i cili kohë më parë kaloi me shumicë votash, por pa nënshkrim të kryetarit të Këshillit. Probleme të këtilla me Këshillat komunale, gjegjësisht formimin e shumicës ka edhe në Komunën e Gostivarit dhe të Tearcës. Në ndërkohë, mos krijimi i shumicës në Këshillin e Komunës së Tetovës, ka bërë që deri më tani - asnjë punë në sferën e infrastrukturës të fillojë, sepse ende nuk ka kaluar edhe programi vjetor për punë në Këshill. Rikujtojmë se edhe para katër vitesh, BDI kishte problem për krijimin e shumicës në Këshillin e Komunës së Tetovës me VMRO-në.

## Arrestohen katër bullgarë për kontrabandim të emigrantëve

Shkup, 11 mars - Katër shtetas të Bullgarisë morën padi penale dhe tetë ditë burgim për kontrabandimin e emigrantëve. Në pikën kufitare "Bogorodicë", pardje u përpoqën që të transportojnë tetë emigrantë ilegalë meshkuj nga Sri-Lanka dhe nga Afganistani të moshës 18 deri në 41 vjeçare. Të denoncuarit L.B (63), P.H (59), I.R (53) dhe T.T (24) më 9 mars në orën 10:30 hynë në pikën kufitare "Bogorodicë" me një autobus "Iveko", me targa kombëtare bullgare, të drejtuar nga i denoncuarit i parë, ndërsa tre të tjerët ishin pasagjerë. "Gjatë kontrollit shtesë mbi mjetet e transportit nga ana e punonjësve të policisë dhe një zyrtari doganor, u gjetën tetë emigrantë ilegalë të gjinisë mashkullore, në një bunker të ndërtuar posaçërisht në pjesën e sipërme të automjetit. Emigrantët janë të moshës nga 18 deri në 41 vjeçare, pesë prej tyre nga Sri-Lanka dhe tre nga Afganistani", njoftoi MPB-ja. Emigrantët në bisedë me policinë thanë se janë marrë nga personat e denoncuar dhe një person i panjohur nga Athina dhe për një pagesë të caktuar duhet të ishin transportuar në Itali. Të katër të denoncuarve iu është dhënë masa e paraburgimit prej tetë ditësh. Disa nga emigrantët janë vendosur në Qendrën e Pranimet dhe disa të tjerët i janë dorëzuar shërbimeve kufitare greke.

## Tre të lënduar në dy aksidente në Hanet e Mavrovës

Gostivar, 11 mars - Tre persona janë lënduar në dy aksidente të veçanta që kanë ndodhur dje në rrugën rajonale Hanet e Mavrovës - Dibër, informojnë nga SPB Tetovë. Në aksidentin e parë që ka ndodhur në afërsi të udhëkryqit me fshatin Verbjan, automjeti "seat toledo" i drejtuar nga B.K nga Dibër, për shkak të shpejtësisë së madhe ka dalë nga rruga, ndërsa lëndime kanë marrë dy bashkëpasagjerë, ku njëri prej tyre është mbajtur në spitalin e Gostivarit. Të shtunën mërkurë rreth orës 19:30 B.J nga Gostivari, duke udhëtuar në rrugën Hanet e Mavrovës-Dibër me makinën "Opel Corsa", ka humbur kontrollin mbi makinën dhe ka goditur një shtyllë ndriçimi metalike. Shoferi i lënduar nga automjeti i dëmtuar është nxjerrë me intervenimin e zjarrfikësve dhe më pas është dërguar në klinikat e Shkupit.

## Mur mbrojtës në hyrje të fshatit Reçan

Gostivar, 11 mars - Kushtet e volitshme atmosferike, mundësuan që të fillojë ndërtimi i murit mbajtës përkaj rrugës në hyrje të fshatit Reçan, ku si pasojë e reshjeve intensive erdhi deri te rrëshqitja e tokës dhe rrezikohej që të shembej rruga dhe të dëmtonte shtëpitë rreth rrugës. Siç njoftojnë nga Komuna e Gostivarit, dje gjatë gjithë ditës, por edhe në orët e vona të natës, është punuar intensivisht në përgatitjen e terrenit, si dhe hapjen e rrugës alternative për në qytet, ndërsa sot ka filluar edhe ndërtimi i murit mbrojtës. Pjesa e paasfaltuar e rrugës që çon prej fshatit deri në Gurëthyesen në magjistralen Gostivar-Kërçovë është zgjeruar dhe është niveluar, duke bërë të mundshëm qarkullimin e papenguar të automjeteve në dy kahe, që nënkupton se përderisa zgjasin punimet ndërtimore, do të mund të shërbejë si rrugë alternative për në qytet. Megjithatë bëhet fjalë për një projekt realizimi i të cilit kërkon shumë punë dhe kohë, pritet që me angazhim maksimal, me punë intensive dhe me orar të zgjatuar, punimet të përfundojnë Brenda katër-pesë ditëve.



# Maqedonia pa Gruevskin, por me gruevizëm dhe me Zaevin pa zaevizëm



Nga  
Rizvan SULEJMANI

Gruevski iku. Nuk iku, por e përzunë. Një dëshirë e madhe e shqiptarëve u plotësua. Bile edhe mund të lavdërohen se pa ndihmën e shqiptarëve, për LSDM-n edhe shumë gjatë do të sundonte. Kush çka fitoj ende nuk mund të përlllogarisim por një gjë e dimë, hija e tij nuk na hiqet. Sa për të mos na marrë "malli" çdo ditë e shohim nëpër TV duke u endur lartë poshtë nëpër gjykata pa epilog. Ai shkoi por gruevizmi mbeti. E shohim në fasadat e institucioneve shtetërore dhe në qendër të qytetit. E shohim kur organizojmë evenimente në teatrin e tij të famshëm. E shohim kur shkojmë në gjykata e operë përreth Vardarit. Na përkujtohet kur shohim shumë kisha e kryqe nëpër qytet e më gjerë të ngritura në kohën e tij. Gruevizmi vazhdon të jetojë dhe bashkë me të edhe ne. Dua të përkujtoj se në kohën kur ishte ngritur i gjithë opinioni kundër tij dhe sundimit të tij unë kisha shtrua pyetjen retorike, çka me gruevizmin, që të përgjigjem, Gruevski do të shkoj por gruevizmi do të mbetet. Aso kohe këtë kush nuk e mendonte, përgjigja ishte e thjeshtë, "vetëm le të ike ky një herë". Ai iku kurse sot e kësaj dite nuk e dimë se çka bëjmë me gruevizmin. Dëgjojmë kryetarin e një farë komisioni për zgjidhjen e këtij problemi, prof Gërçev, që bën listë përmendoresh e monumentesh që duhet rrënuar. Për çudi, në atë listë edhe monumenti i Nënë Terezës, por edhe i Hasan Prishtinës. Çka është e përbashkëta e gruevizmit me Nënë Terezë e Hasan Prishtinës? Apo edhe Aleksandri e Filipi me Nënë Terezë. Të parët luftarak e perandorë, e dyta paqësorë, mirëbërëse dhe mbrojtëse e të pamundur dhe hallexhinje. Po, duket se kanë diçka të përbashkët, që të dy e kanë shpie namin e "Maqedonisë" deri në Indi. Sikur të kishin jetuar në të njëjtën kohë do të mund të thoshim se njeri ka vvarë, Aleksandri kurse tjetra, Gonxhe Bojaxhiu ka mjekuar të vvarit. Kjo është koha e Zaevit, kemi Zaevin e shumëpritur kryeministër por nuk kemi zaevizëm. E dimë/nuk e dimë, se çka duhet rrënuar por jo edhe çka duhet ndërtuar. Cilat kishin mund të jenë pikat referuese që do të mund ta shënojnë qeverisjen e tij të deritanishme? Një, formoj komision për mbrojtjen e bashkësisë së LGB-së dhe dy, lirimi i një numri të madh përsosur sa të fajshëm e sa të pafajshëm. Kjo mund të përputhet me një nga sloganet parazgjedhore të tija, liri për të gjithë. Por, liria nuk mbaron

këtu dhe nuk është për të gjithë njerëz. Sot disa njerëz mund të parkohen kudo kurse policia të mos mund ti dënojë. Disa të tjerë mund të vrasin e plagosin në mes të ditës dhe policia të mos i zbuloj. Ka të tillë që sunetinë nga çështje religjioze e kanë trajtuar si kulturë. Bile ndodhë që nënkryetari i qeverisë të ndaj tender për firmën e vet, kurse funksionarët të kategorisë së tretë që vijnë nga "revolucionit i larmë" të udhëtojnë dhe ushqen me super vip-kushte. Paramendoni një artist antiregjim si do ta paraqes në artin post modern jo barok, zaevist. Një gjë të tillë e bëri Vladimir Millçini në një dramë të tij. Dramën nuk e kamë parë por përshkrimi i funksionimit të shtetit për momentin me fjalët, "curi od site strani" (rrjedh nga gjitha anët), më jep idenë si do të mund të portretizohet zaevizmi nëse vazhdon kështu. Pasi statuja e Aleksandrit në qendër të Shkupit simbolizon gruevizmin, zaevizmi i tanishëm me fjalët e Millçinit mund të simbolizohet me një bure që rrjedh nga gjitha anët. As burja mbushet as uji shteret, një domethënie për sloganin, "zhivot za site" (jetë për të gjithë). Burja rrjedh, por nuk zbrazet, njerëzit ujën e shohin por janë të etur. Nëse kështu e shef situatën njeriu që më së shum-

ti i mobilizoj shqiptarët për ta rrëzuar regjimin duke u mbajtur nasijat për demokraci, shtet qytetarë dhe për Evropë e NATO që do të vijnë pas, pse ne të mos e komentojmë qëndrimin e tij për gjuhën dhe emrin. Fatkeqësisht nga ajo çka tha u binda se gruevizmi lere se është mbjellë thellë në kokat e intelektualëve maqedonas porse sa i përket çështjes shqiptare dhe të emrit, sikur dëgjoja britmën, "kthehu Grujo".

Kjo na bën të shtrojmë pyetjen cili është misioni i Zaevit? A është e vërtetë ajo që më tha një funksionar i lartë i partisë në qeveri; Zaevi nuk erdhi në pushtet por atë e sollën. E sollën me një detyrë; ta ndërroj emrin e shtetit për tu bërë anëtarë të NATO-s. Ndoshta ai i dinë obligimet që i ka marrë por njerëzit që e ndihmuan ardhjen e tij, janë larg për ta kuptuar atë. Të supozojmë se Zaevi i dinë detyrat shtetërore, por sa dhe si i punon ata? Nga një optimist i papërmirësueshëm që ishte derisa flitej për pakon përplot premtime të bukura që do të vijnë pas ndërrimit të emrit, tani kur vjen fatura me çmimin që duhet paguar, duket se entuziazmi shndërron në ankth. Optimizmi bie, zërat kundër rriten, pakënaqësia shtohet. Faktorin ndërkombëtarë mundohet

**Nëse nuk ka ide të re me të cilën do të identifikohet dhe mishërohet populli që do të lidhet me Zaevin, kam frikë se gruevizmi do të mbetet përgjithmonë. A do të ketë zaevizëm, nuk varet vetëm nga ajo sa do të rrënohet gruevizmi, por edhe sa do të ndërtohet zaevizmi. Për këtë detyrimisht duhet të kesh një ide autentike për një Maqedoni ndryshe nga ajo deritanishmja, që do të depërtojë në vetëdijen e njerëzve, do të mishërohen me te, por edhe simbolizohet me diçka**



t'ia mbaj optimizmin. Çdo ditë e takon, e inkurajon dhe përgëzon duke i paraparë ardhmëri të ndritur. Në këtë funksion Junkeri shkoj më së largu, i bëri një puthje jo të zakonshme gjatë pritjes para qeverisë sa që la hapësirë për komente në një nga televizion më të shikuara në vend. Pastaj, kur u kthye në Bruksel sqaroi se askujt si ka premtuar datë, por tha se maqedonasit e kanë kuptuar kurse shqiptarët, jo (mendohet për ata të Shqipërisë). Slogani një shoqëri për të gjithë has në vështirësi. Pasi u harmonizua ligji për gjuhët me BDI-në, u dha besa shqiptare se do të përkrahet nga të gjithë, paraqitet të ketë probleme. I mëveshët si opstrukcion VMRO-DPMNE-s por shumë zëra kundër ka edhe nga ideatorët e revolucionit të larmë dhe brenda vetë LSDM-së. Përskaaj premtimit se me këtë do të krijohen kushte për një shoqëri të përbashkët duket se ligji do të përshtatet për shoqëri të ndarë. Përdorimi i gjerë i gjuhëve të komuniteteve do ngushtohet, do të bëjë distinkcion ndërmjet të parëve, maqedonasve, dhe shqiptarëve e të tjerët, sa për tu ditur se i "kujt është shteti". Gjegjësish, është më lehtë ligji të ndryshohet për të vërtetuar se shoqëria jo që është e ndarë por ka edhe hierarki, sesa të jetë një e përba-

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e diel 11 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Sot është vështirë të nxirret një portret se kush është Zaevi dhe çfarë është zaevizmi. Kur flasim për gruevizëm e zaevizëm kemi parasysh thënien e vjetër romake: "Populli sundohet me bukë dhe lojëra". Gruevski nuk ju dha shumë bukë popullit, por u bëri shumë lojëra. Koloseumet janë dëshmi për sundimin e disa sundimtarëve romak me bukë e lojëra. Ndërtesat e përmendoret përreth Vardarit dhe në qendër të qytetit do të mbeten dëshmi për kohën e Gruevskit, kur sundohej vetëm me lojëra e pa bukë



shkët për të gjithë. Nuk do të më vinte inati sikur një epilog të tillë të mundshëm për këto dy çështje të rëndësishme të mos i kisha paralajmëruar me shkrime dhe paraqitje publike kur shumë të tjerë ishin në kulmin e euforisë për një zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë, por ja që njerëzit duan tu besojnë më tepër dëshirave të mira sesa realiteteve të hidhura.

Nga ky këndvështrim sot është vështirë të nxirret një portret se kush është Zaevi dhe çfarë është zaevizmi. Kur flasim për gruevizëm e zaevizëm kemi parasysh thënien e vjetër romake: "Populli sundohet me bukë dhe lojëra". Gruevski nuk ju dha shumë bukë popullit, por u bëri shumë lojëra. Koloseumet janë dëshmi për sundimin e disa sundimtarëve romak me bukë e lojëra. Ndërtesat e përmendoret përreth Vardarit dhe në qendër të qytetit do të mbeten dëshmi për kohën e Gruevskit, kur sundohej vetëm me lojëra e pa bukë. Ky është gruevizmi që do të përkujtoj kohën e tij. Zaevi për momentin nuk ofron as bukë as lojëra. Nëse nuk ka ide të re me të cilën do të identifikohet dhe mishërohet populli që do të lidhet me Zaevin, kam frikë se gruevizmi do të mbetet përgjithmonë. A do të ketë zaevizëm, nuk varet vetëm nga ajo sa do të rrënohet gruevizmi, por edhe sa do të ndërtohet zaevizmi. Për këtë detyrimisht duhet të kesh një ide autentike për një Maqedoni ndryshe nga ajo e deritanishmja, që do të depërtojë në vetëdijen e njerëzve, do të mishërohen me te, por edhe simbolizohet me diçka. Sa do të ketë bukë e sa lojra, është herët për tu konstatuar. Të mos ndodhë buka e loja e këtij pushteti të jetë thënia boshnjake, "voxhen zhedan preku vode" (të kalosh ujin e të mbetesh i etur).

(Autori është kolumnisti i rregullt i gazetës KOHA)

## Zbrazëtia politike që dobëson Italinë dhe Evropën



Nga Bernard GUETTA

Italia që doli nga zgjedhjet në 4 mars është e paqeverisëshme, dhe e tillë do të mbetet deri kur italianët të thirren për të zgjidhur krizën duke u kthyer të votojnë, ose, pasi muaj të tërë tratativash do të kenë prodhuar afrime palësh, që për momentin ngjajnë të pamundura. Me fjalë të tjera, lajmet janë shumë të këqija për ekonominë e tretë të Evropës dhe për vetë Unionin, të cilit kjo rrëmujë sigurisht që nuk ia lehtëson rimëkëmbjen. Po vërtetë mund të flasim për katastrofë?

Fillojmë nga arsyet e shqetësimit. Në një moment kur bota ka nevojë për një Evropë të fortë dhe të aftë për të shtuar peshën e saj në skenën ndërkombëtare, zgjedhjet italiane konfirmojnë krizën e dy forcave të mëdha politike, që kishin strukturuar skakierën kombëtare dhe panevropiane, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Socialdemokracia dhe Demokracia kristiane humbasin

zgjedhës pas çdo votimi. Dhe padyshim është një fenomen i rëndë, sepse (me përjashtim të Francës së Macronit), forcat që duhet t'i zëvendësojnë janë ende në fazë embrionale. Është krijuar një boshllëk, që na dobëson të gjithëve dhe do të na dobësojë për një kohë të gjatë. Arsyeja e dytë për t'u shqetësuar është që ekstremet e reja të djathta, me një mesatare votash prej 20%, po ndërftohen në skakierat politike. Kudo nga pak, atje ku e djathta beso se i reziston përparimit të ekstremizmit duke përvetësuar sloganet e tij, në të vërtetë bën që të përparojnë ekstremistët, siç sapo e pamë në Romë. Por të kalojmë tek arsyet përse nuk duhet të thërrasim që erdhi fundi i botës.

E para është që fashizmi nuk pushton Romën, ku e djathta ekstreme ka gjithsesi më pak vota se Fronti Nacional në Francë. Arsyeja e dytë është se, italianët janë kaq pak të prirur për të fundosur Bashkimin Evropian,

Në një moment kur bota ka nevojë për një Evropë të fortë dhe të aftë për të shtuar peshën e saj në skenën ndërkombëtare, zgjedhjet italiane konfirmojnë krizën e dy forcave të mëdha politike, që kishin strukturuar skakierën kombëtare dhe panevropiane, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore



saqë lëvizja Pesë Yjet, e cila u bë e para parti e Italisë nën valën e sloganit "vaffanculo", i ka kaluar javët e fundit duke bërë hapa prapa nga euro-skepticismi i mëhershëm, he tani ka braktisur çdo ide për dalje nga euro. Dështimi i Le Penit u hapi sytë shumë njerëzve në BE. Në Evropë nuk ka një shumicë të vendosur për të ndjekur shembullin britanik, dhe ndoshta kjo shumicë nuk është as në Mbretërinë e Bashkuar, sepse përballë Trumpit, Putinit dhe kaosit në Lindjen e Mesme, evropianët ndjejnë nevojën që të shtrëngojnë radhët. Përgjegjësitë e Emmanuel Macronit dhe Angela Merkelit nga 4 marsi janë shtuar, pasi BE do të gjendej shumë shpejt në fundin e vet, nëse "Evropa që mbron" nuk do të merrte menjëherë formë me një mbrojtje, një politikë fiskale, investime dhe mbikëqyrje të kufijve të përbashkët, me të vërtetë panevropiane.

(France Inter)

## Vrasja e gazetarit në Sllovaki, sinjal paralajmërues për Europën



Nga Keno VERSECK

Vrasja e gazetarit sllovak, Ján Kuciak dhe e të fejuarës së tij Martina Kúšnírová e ka tronditur Sllovakinë si pak ngjarje të rëndësishme që nga pavarësimi i vendit para 25 vitesh. Ndjenja e shokimit dhe tronditja e thellë përzihet gjithnjë e më shumë me zemërimin. Shprehje e kësaj ishte të premtën demonstrata më e madhe në Sllovaki që nga koha e revolucionit të kadifentë në vjeshtën e vitit 1989. Në të gjithë vendin qindra mijëra vetë dolën në rrugë, 50.000 vetë vetëm në Bratislavë, për një vend prej 5 milionë vetësh, një numër i konsiderueshëm. Motoja e mitingut ishte "Le të angazhohemi për një Sllovaki të ndershme!" Njerëzit dalin në rrugë kundër korrupsionit e keqpërdorimit të pushtetit, kërkojnë më shumë drejtësi, më shumë transparencë dhe qeverisje të përgjegjshme. Ndërkohë që demonstratat e tanishme janë më të mëdhatë, por jo të parat. Ka vite që periodikisht zhvillohen protesta kundër qeverisë së Robert Ficos dhe partisë së tij socialdemokrate, SMER-SD. Gazetarë investigativë zbulojnë

rregullisht skandale korrupsioni të SMER dhe qeveritarëve të tjerë, njëri më skandaloz se tjetri, pa ndonjë pasojë politike apo juridike. Pas këtyre protestave fshihet një pakënaqësi e thellë e përgjithshme me mënyrën e transferimit nga diktatura socialiste në demokraci dhe ekonominë e tregut. Sllovakia nga pikëpamja makroekonomike konsiderohet me të drejtë një vend i suksesshëm në pjesën lindore të BE. Por çmimi për këtë ka qenë i lartë: Pas fundit të diktaturës qindra mijëra vetë dolën nga ana sociale humbës të politikës ekonomike reformuese.

Ata ndoshta do ta pranonin këtë gjendje, po të mos shikonin, se si një elitë e vogël, anëtarët e të cilës shpesh që në diktaturë bënin pjesë tek fitimtarët, në mënyrë të paturpshme dhe kriminale u pasuruan me pasurinë e dikurshme të popullit. Ky lloj vetëshërbimi vazhdon edhe sot, vetëm se të pushtetshmit kujdesen për të ruajtur më shumë fasadën e legalitetit përmes trukeve juridike apo me miratimin e ligjeve që lenë hapësira të mëdha për anashkalim. Por e moralshme kjo mbetet. Dhe e


mbuluar nga kryeministri, Robert Fico dhe partia e tij përmes një retorike herë populiste të majtë, herë të djathtë nacionaliste. Sa e drejtë dhe e madhe është pakënaqësia e qytetarëve sllovakë, po kaq pak ia kanë dalë lëvizjet shoqërore të kthehen në fuqi politike. Nuk ka një alternativë të fortë politike, që angazhohet në mënyrë të besueshme për më shumë shtet të së drejtës, më shumë drejtësi sociale e demokraci më të mirë. Një pjesë e partive opozitare janë vetë të diskredituara përmes qeverisjeve të mëparshme. Si alternativa vetëofrohen populistët e ekstremit të djathtë. Ky zhvillim i ngjason atyre të shumë vendeve europianolindore. Shumë vëzhgues në Sllovaki i tremben zhvendosjes së vendit si në Hungari apo Poloni. Opinioni publik në BE dhe jashtë tij është shumë pak i vetëdijshëm për sfondin e vrasjes së Kuciak dhe implikime të mundshme politike të tij. Ajo që po ndodh tani në Sllovaki duhet të jetë një sinjal paralajmërues që të shihet edhe jashtë me më shumë vëmendje zhvillimi aktual dhe të mbështetet lëvizja shoqërore demokratike. (DW)

Politikës europiane dhe opinionit publik jashtë Sllovakisë nuk i janë bërë edhe aq të vetëdijshme sfondi i vrasjes së gazetarit Ján Kuciak dhe implikimet e mundshme politike të tij



## Alioski, cak i tifozëve të Lidsit

Ezgjani Alioski është në shënjestër të tifozëve të Lidsit. Në momentin kur Lidsi lajmëroi se Alioski do të luajë për Maqedoninë, në sfidat miqësore me Finlandën dhe Azerbajxhanin, tifozët anglezë përcollën mesazhe se nuk janë të kënaqur me të dhe i kanë rekomanduar që të largohet sa më shpejtë. Alioski erdhi në Lids për 2.23 milion sterlina, mirëpo assesit që të përfitojë simpatinë e tifozëve. Edhe kur shënonte gola dhe ishte futbollist i muajit, nuk arrinte të përfitojë tifozët anglezë. Dhe gjërat janë përkeqësuar edhe më shumë nga muaji dhjetor e këtej, pasi ka vetëm një asistim dhe një gol të shënuar.



## LIGA E PARË, JAVA E 23

Shkupi ka arritur barazimin e radhës, kësaj here djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu barazuan me Sileksin në Kratovë. Lideri aktual Shkëndija vazhdon me fitore, ku viktimat e radhës ka qenë Rabotnički, derisa fitoren e parë në sezonin pranveror e arriti skuadra e Renovës



## MUNDJE, TURNIRI "ZLATI DINEV ROYDEV" NË BULLGARI



## Alili kampion, Ramadani i bronzë

Shkup, 11 mars - Në turnirin prestigjioz për fëmijë dhe të vetmin të kësaj grupmoshe në kalendarin vjetor të Federatës Ndërkombëtare të Mundjes "Zlati Dinev Roydev", mundësi dhe margaritari i klubit të mundjes "Liria", Besir Alili, arriti të shpallet kampion, duke fituar medaljen e arit në kategorinë deri 44 kg. Në finalen e madhe të kësaj kategorie, Alili ishte i shkëlqyer ndaj medalistit të bronzë nga evropiani i fundit për fëmijë, Giorgi Gogritsiani nga Gjeorgjia, të cilin arriti ta mposhtë pas një beteje të vërtetë dhe në mënyrë mëse të merituar. Ndryshe, për Alilin ky ishte një sukses tjetër i madh dhe paralajmërim për sukseset që e presin gjatë këtij viti dhe në të ardhmen. Ndërkohë, një tjetër sukses për KM "Liria" është edhe medalja e bronzë e fituar nga Muhamed Ramadani. Ai në kategorinë deri 85 kg, në garat e repasazhit arriti të fitojë dy kundërshtar bullgar dhe me këtë arriti të fitojë medaljen e bronzë në këtë turnir mjaftë prestigjioz.

# SHKËNDIJA NUK FAL, BARAZON SHKUPI

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 11 mars - Skuadra e Shkupit arriti të fitojë një pikë në ndeshjen ndaj Sileksit në Kratovë, duke luajtur baras 1-1 në kuadër të javës së 23 në Ligën e parë futbolistike të Maqedonisë. Të parët në epërsi kaluan nikoqirët me golin e brazilianit De Oliveira Zhunior, ndërsa sulmuesi Bazhe Ilijoski me golin në momentet e fundit të pjesës së parë, barazoi rezultatin në 1-1. I njëjti futbollist në pjesën e dytë u ndal në mënyrë të palejuar, mirëpo referi Stavrev

nuk tregoi në penallti përkundër protestave të futbollistëve të Shkupit. Me këtë barazim Shkupi ngjitet në pozitën e katërt me 29 pikë, shtatë më pak se Sileksi, por që kjo e fundit ka edhe një ndeshje më pak.

Shkëndija nuk ka ndërmend të ndalet, teksa pasditën e së shtunës ka marrë një tjetër fitore, 0-2 ndaj Rabotniçkit në kampionat. Ka qenë Izair Emini ai që zhbllkoi rezultatin në fundin e pjesës së parë, duke mbajtur edhe premtimin e dhënë në intervistën para ndeshjes, për të vijuar me shënimin e golave. Në

pjesën e dytë, ishte golashënuesi më i mirë i kuqezinjve, Besart Ibrahimiqi që dërgoi topin në rrjetë dhe vulosi fitoren për kuqezinjët. Nga ana tjetër, Rabotnički luajti me një lojtar më pak, përreth 40 minuta, pas ndëshkimit me karton të kuq të Trajçevskit. Me këtë 3-pikësh, Shkëndija vijon të 'fluturojë' drejt titullit, duke e çuar në 18 pikë diferencën nga Vardari ndjekës, që dje luajti baras pa gola ndaj rivalit lokal Skopje. Pa gola ka përfunduar edhe takimi mes Pobodës dhe Akademija Pandevit. Ndërkohë, fitoren e

### REZULTATET:

RABOTNIČKI – SHKËNDIJA	0:2
RENOVA – PELISTERI	1:0
SILEKSI – SHKUPI	1:1
SKOPJE – VARDARI	0:0
POBEDA – A.PANDEV	0:0

parë në sezonin pranveror e ka arritur skuadra e Renovës. Me rezultatin 1-0, bardhekalitë kanë mundur Pelisterin në stadiumin e qytetit në Tetovë. Autor i golit të fitores ka qenë Valmir Nafiu në minutën e 57.



## Hamza i artë në Zagreb

Shkup, 11 mars - Hamza Jashari ka shkëlqyer në kampionatin evropian në xhudo për kadet, i cili u mbajt në Zagreb. Me një bilanc prej 5 ipon dhe 2 vazaria dhe në një konkurrencë të fortë ku morën pjesë 86 garues, Hamza ishte superior, derisa kjo medalje e arit është e dytë për at në kupat evropiane gjatë këtij viti. Cekim, në Gyor të Hungarisë, Hamza triumfoi në kampionatin evropian për kadet. Sa i përket medaljes së arit në Zagreb, Hamza fillimisht fitoi me ipon kroati Hlapčić, hungarezin Oksai e mundi me ipon dhe vazari, derisa me ipon gjithashtu e mundi edhe gjermanin Kansi dhe austriakun Visinger. Ndërkohë, në gjysmëfinale festoi kundër rusit Kozlov me vazari dhe në finale me ipon mundi austriakun Gasner.

## KB Shkupi shijon fitoren e parë në pranverë

Shkup, 11 mars - Klubi i Basketbollit "Shkupi", shënoi fitoren e parë në sezonin pranveror, duke mundur skuadrën e Karposh Sokolit me rezultat 107-91, në njërin nga përballjet e javës së 18-të të Super Ligës së basketbollit. Në çerekun e parë u realizuan 67 pikë dhe Shkupi shënoi 38 përball atyre 29 të Karposh Sokolit, ndërsa në pushim të pjesës së parë KB Shkupi shkoi me epërsi 11 pikë. Ndërsa, në vazhdim KB Shkupi shtoi diferencën edhe për dhjetë pikë të tjera, pas se cilës ishte e




qartë se kush do të jetë fitues, Vetëm në çerekun e fundit, Karposh Sokoli e fitoi me rezultat 26-21, mirëpo në fund, në tabelë u regjistrua rezul-

tati: Karposh Sokoli 91, ndërsa KB Shkupi 107. Më efikas te KB Shkupi ishin Adekoge me 23 pikë, i ndihmuar nga Rid me 21 pikë.

HADIS RAMADANI, KIK-BOKSIER

# DUA TË BËHEM KAMPION BOTE NË TË GJITHA VERSIONET



“Në të ardhmen synoj të zhvilloj më tepër ndeshje profesionale, ndërsa ëndrra ime është që të bëhem kampion bote në të gjitha versionet”, përfundoi Hadis Ramadani.

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 11 mars - Hadis Ramadani nga Shkupi është njëri prej kik-boksierëve më të talentuar shqiptar. Me fitoret që është duke i arritur, paralajmëron se pret një e ardhme e mirë. Për gazetën KOHA, ai rrëfen hapat e parë me këtë sport aspak të lehtë, luftërat e zhvilluara përfshi ato profesionale, fitoret më të veçanta dhe synimet e tija në të ardhmen. “Me kik-boks kam filluar të merrem prej vitit 2008 nën udhëheqjen e trajnerit Naser Mecinoviq. Fillova të merrem me këtë sport duke marr

parasysh se si fëmijë e dëshiroja shumë. Për këtë e falënderoj Zotin që ma mundësoi të merrem me këtë sport”, fillon rrëfimin e tij Ramadani. Me të filluar stërvitje për Hadisin erdh momenti për të dalë në ring. “Lufta ime e parë ka qenë kundër një kundërshtari nga Maqedonia në një turnir i cili u mbajt në Shtip. Fatmirësisht arrita fitore edhe atë me pikë, fitore kjo e cila më dha shtytje për të vazhduar tutje me fitoret e radhës”, shtoi më tej Ramadani. Ndryshe, pasi garoi si amator, Ramadani deri më tani ka zhvilluar nëntë meçe si profesionist dhe të gjitha janë fitore. Derisa për KOHA tregon se cila nga këto nëntë fitore, i ka lënë më shumë përshtypje. “Pasi në fillim garoja si amator, fillova të marr pjesë edhe si profesionist. Deri më tani kam zhvilluar nëntë meçe profesionale dhe të gjitha janë fitore. Derisa, meçi që më ka lënë më së

shumti përshtypje ka qenë fitorja kundër kik-boksierit serb Aleksandar Xhorxheviç në Serbi. Këtë fitore nuk do ta harroj asnjëherë, ndërsa prezent ka qenë edhe kryetari i Serbisë, Ivica Daçiç. Në anën tjetër fitorja më e vështirë të cilën e kam arrit ka qenë ajo ndaj kik-boksierit gjerman Abdolazim Fahim, i cili kishte 30-të vjeç”. Në fund Hadis Ramadani foli edhe për planet e tija për të ardhmen. “Në të ardhmen synoj të zhvilloj më tepër ndeshje profesionale, ndërsa ëndrra ime është që të bëhem kampion bote në të gjitha versionet”, përfundoi Hadis Ramadani.



## E VËRTETA E FESTIMIT ME SIMBOLIN E SHQIPONJËS NË MES TË GREQISË

Shkup, 11 mars - Ai është vetëm 25 vjeç, por ka pas krahëve një karrierë të çmendur dhe ka luajtur me aq shumë skuadra sa është e vështirë për t'u besuar. Pajtimi Kasami, futbollisti me prejardhje nga Struga që ka zgjedhur të luajë me përfaqësuesen e Zvicrës, aktualisht aktivizohet me Sionin në kampionatin zviceran. Në të kaluarën ka luajtur me klube si Liverpool, Lacio, Palermo, Fulham, Olimpiakos, Nottingham Forest apo edhe me disa skuadra të tjera zvicerane. Në një intervistë të dhënë për median lokale Kasami ka folur gjerë e gjatë për karrierën e tij, problemet dhe arsyet pse ende nuk ka arritur të bëhet një futbollist i nivelit të lartë ndërkombëtar, edhe pse ka një potencial të jashtëzakonshëm teknik dhe një eksperiencë të madhe. Mes të

tjerash, Kasami ka folur edhe për një moment të rëndësishëm, që shkaktoi polemika dhe ndezi debate.

Më 22 tetor 2014 ai shënoi golin e fitores së Olimpiakos ndaj Juventusit, teksa mesfushori nga Struga, fill pasi mposhti portierin Cjanluigji Buffon, bëri me duar shenjën e shqiponjës dy krenare në mes të stadiumit “Karaiskaqi” të Athinës.

Bëhej fjalë për një ndeshje të vlefshme për Çampions Ligë dhe jehona ishte e madhe, ndërsa menjëherë media greke e cilësoi një provokim të rëndë, pasi sipas tyre shqiponja është simbol i “Shqipërisë së Madhe”. Ky gjest nuk u prit mirë edhe në Zvicër, duke qenë se lojtari kishte zgjedhur të luan-te me përfaqësuesen helvete duke refuzuar kombëtaren shqiptare. Gjith-

sesi, thuhet se mesfushori është shumë i lidhur me rrënjët e tij shqiptare. Vetë Kasami duke folur në intervistën e fundit ka sqaruar edhe arsyen e festimit në atë mënyrë.

“Festova me shqiponjën pasi doja të tregoja solidaritetin tim me futbollistët e Kombëtares shqiptare, që pak ditë më parë kishin luajtur në Beograd ndaj Serbisë (ndeshja famëkeqe e 14 tetorit 2014) për eliminatorët e Evropianit Francë 2016”, - shpjegon Kasami, i cili pas asaj ndeshjeje të katër viteve më parë do të deklaronte se e bëri këtë gjest vetëm për shkak të origjinës së tij shqiptare. Pas katër vitesh mesfushori duket se ka vendosur të rrëfejë arsyen e vërtetë.

## KLUBET E SERIA A

## 130 MILIONË EURO PËR ZERO REZULTATE

Milan dhe Roma janë klubet që kanë investuar më shumë te talentet e sulmit dhe golashënues të afirmuar. Por rezultatet nuk kanë qenë aspak të kënaqshme, të paktën deri në këtë moment

Më shumë se 130 milionë euro për pak gola. Merkaton e verës së kaluar ka qenë ai i shpenzimeve të çmendura për sulmuesit. Milan dhe Roma janë klubet që kanë investuar më shumë te talentet e sulmit dhe golashënues të afirmuar. Por, rezultatet nuk kanë qenë aspak të kënaqshme, të paktën deri në këtë moment. Kuqezinjtë



kanë paguar 38 milionë euro për Andre Silva, i marrë nga Porto. Portugezi nuk ka shënuar akoma asnjë gol në kampionat dhe drejtuesit e klubit milanez po mendojnë ta huazojnë sezonin e ardh-

shëm. Gjërat nuk kanë shkuar më mirë për Kaliniç, i marrë nga Fiorentina për 25 milionë euro, i cili ka shënuar vetëm 4 gola në këtë sezon. Probleme të ngjashme edhe për Roman, që ka fituar garën

me Inter për Shik, i blerë për 42 milionë euro nga Sampdoria, por që nuk ka shënuar akoma në Serinë A. Pak më mirë ka bërë edhe ish-sulmuesi i Sassuolo, Defrel. Si në rastin e Kaliniç, nëse të rinjtë nuk bindin, as ata që supozohej të ishin golashënues të afirmuar nuk kanë shkëlqyer. Edhe ekipet e vogla kanë investuar shumë, por pa marrë gola e shpresuar (në shumë raste të rëndësishëm për mbijetesën). Mjafton të mendohet për 13 milionë euro-t e shpenzuar nga Xhenoa për të marrë Lapadula nga Milan (2 gola deri tani). Borriello, te Spal, është një nga lojtarët më të paguar të ekipit dhe ka shënuar vetëm një herë. I njëjti rezultat edhe për lemmello, që i ka kushtuar Beneventos më shumë se 6 milionë euro.



## Junajted në sulm për yllin e Juventusit

Gjatë muajve të fundit Antonio Conte e kërkoi disa herë për ta marrë te Çellsit si përfundim, por nuk ia doli dot. Ndërsa tani, në gjurmët e Aleks Sandro, anësorit të majtë të Juventusit, është vënë në ndjekje skuadra e Manchester Junajted. Sipas të përditshmes britanike "The Mirror", trajneri Hoze Murinjo do të hidhet në sulm verën e ardhshme për ta sjellë në "Old Trafford" brazilianin, duke lënë të lirë mbrojtësin italian Matteo Darmian, që do të rikthehet në Serinë A, për të luajtur me bardhezinjtë. 27-vjeçari Aleks Sandro erdhi 3 sezone më parë nga Porto, me Juventusin që pagoi 22 milionë euro për ta marrë, duke rezultuar si një nga mbrojtësit më të mirë në Evropë. Ndaj dhe Murinjo e konsideron si blerjen e duhur, duke qenë se Eshli Jang nuk është konstant në paraqitjet e tij. Tashmë Sandro mund të kushtojë rreth 70 milionë sterlina, një shumë që mund të ulet nëse në marrëveshje hyn edhe Darmian, ndërkohë që Junajted është gati ta paguajë 145 mijë sterlina në javë.

## Çellsit e Junajted në garë për Umtitin

Çellsit është e interesuar të joshë mbrojtësin e qendrës të Barcelonës, Samuel Umtiti në "Stamford Bridge" gjatë merkatos së transferimit të kësaj vere, raporton "Daily Express". Tabloidi britanik beson, se "Blutë" janë të gatshëm të bëjnë një sakrificë të madhe ekonomike për të nënshkruar me francezin, i cili është në kontratë me katalanasit deri në qershor 2021. Sidoqoftë, klubi i Londrës do të përballlet me konkurrencë nga Manchester Junajted, me trajnerin Hoze Murinjo që e ka identifikuar ish-kapitenin e Lionit, si një objektivi kryesor për sezonin e ardhshëm. Megjithatë, nëse Umtiti vendos t'i bashkohet Çellsit, trajneri portugez ka piketuar Sokratis Papatstathopoulos të Borussia Dortmund. Në të vërtetë, kontrata e ish-mbrojtësit të AEK-ut dhe Mi-



lanit do të përfundojë në fund të sezonit të ardhshëm. Prandaj, Borussia mund të tundohet për ta shitur qendërmbrojtësin në merkato, në mënyrë që të shmangin mundësinë e humbjes së tij pa fituar asgjë.

## Klajvert i kënaqur me interesimin e Barçës

Talenti i Ajaksit, Patrik Klajvert është shumë i kënaqur me interesimin nga Barcelona për shërbimet e tij. Pavarësisht se zbuloi se zemra e tij ishte në Barcelonë, futbollisti i ri e pranoi se ai nuk do t'i thoshte jo një oferte nga rivalët e Real Madridit. Është folur madje se Lionel Messi i ka thënë bordit të Barcelonës të sjellë Klajvert në "Camp Nou", dy dekada pasi babai i tij mbërriti në Kataluni, por holandezi nuk e di për një gjë të tillë. "Unë nuk jam në kontakt me Messin, kështu që nuk e di nëse

është e vërtetë", ka thënë fillimisht Klajvert për "FourFourTwo". "Vetëm ai e di se çfarë ka ndodhur, por është mirë të dëgjosh 'për interesimin e Barçës'". 18-vjeçari gjithashtu foli edhe për takimin e tij me Hoze Murinjon në finalen e Ligës së Evropës. "Ai 'Mourinho' më tha se ishte mirë të më shihte përsëri pas kaq shumë kohe, sepse ai më kishte njohur që kur isha fëmijë", shtoi ai. "Ai tha se ishte e mrekullueshme të më shihte dhe se po bëj mirë", përfundoi talenti i Ajaksit.



Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/14 dhe 113/14) në pajtim me nenin 80 dhe nenin 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41, 116/14, 135/14) dhe Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nën nr. 12-136/4 të datës 15.02.2018, Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 12-2377/2 të datës 05.03.2018, Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me nr. 12-10979/2 të datës 05.12.2017, SHFK "Strasho Pinxhur" – Kurbinci publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- Mësimdhënës për mësim klasor për mësimin në gjuhën maqedonase me 20 orë mësimore (zëvendësim për drejtorin e emëruar në çerdhe) – 1 realizues,
- Mësimdhënës për informatikë me 8 orë mësimore dhe projekte nga informatika (zgjedhore) me 4 orë mësimore – 1 realizues,
- Mësimdhënës për etikë me 3 orë mësimore – 1 realizues
- Mësimdhënës të gjuhës angleze me 7 orë mësimore – 1 realizues.

### Për punësim për kohë të pacaktuar të punës

- Mirëmbajtës të higjienës në SHP Tarinci me 40 orë punë – 1 realizues
- Orari i punës së mësimdhënësve është prej ora 07:00 deri në ora 13:00 sipas numrit të orëve nga orari i orëve për vitin shkollor 2017/18, ndërsa për mirëmbajtësin e higjienës prej ora 07:30 deri në ora 14:30.

Kandidatët të parashtrajnë lutjet në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim fillor në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

### Dokumentet e nevojshme:

- Lutje,
- Diplomë ose Certifikatë për arsim të mbaruar dhe
- Certifikatë të shtetësisë

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit ndërsa do të realizohet në afat prej 15 ditëve.

Lutjet së bashku me dokumentet e kompletuara të parashtrihen deri në SHFK "Strasho Pinxhur" Kurbinci. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtriuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

SHFK "Strasho Pinxhur" Kurbinci

Tel për kontakt:

032/300-002

Në bazë të nenit 131 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009..... dhe 127/2016), nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit.

### KONKURS

Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor

zgjedhje të 1 (një) mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat mësimore-shkencore:

- inxhinieria tekstilit-mekanike
- dizajnim të tekstilit dhe veshjes
- marketing menaxhment

Kushtet: Kandidatët e paraqitur krahas kushteve të përgjithshme duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrajnë: fletëparaqitje për konkurs, biografi të shkurtër, deklaratë për përbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Dokumentet parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës është përcaktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet parashtrihen deri në Fakultetin teknologjik-metalurgjik Shkup, rr. "Rugjer Boshkoviq" nr. 16, 1000 Shkup.

Fakulteti teknologjik-metalurgjik Shkup

## NGA VAN BASTEN-SAKI TE POGBA-MURINJO



## Nejmar ka vendosur të mos luajë më te PSZH-ja



# JUNAJTED KËRCËNON FRANCEZIN

Sipas "The Independent", është ajo që ka ndodhur te Mançester Junajtedit, ku kanë përdorur pak fjalë për të bindur Pogba që të zgjidhë mosmarrëveshjet ekzistojnë mes tij dhe Hoze Murinjios.

Historia e futbollit është e mbushur me histori largimesh dhe shpesh klubet e shikojnë veten në një udhëkryq për shkak të marrëdhënieve të këqija mes një lojtari dhe trajnerit. Mjaf-ton të kujtosh Saki-Van Basten te Milan dhe Kuper-Ronaldo tek Inter, sa për të përmendur rastet më të famshme. Ndodh shumë rrallë që kërcënimi të vijë direkt nga klubi. Por kjo, sipas "The Independent", është ajo që ka ndodhur te Manç-

ster Junajtedit, ku kanë përdorur pak fjalë për të bindur Pogba që të zgjidhë mosmarrëveshjet ekzistojnë mes tij dhe Hoze Murinjios. "Ose je me të në 100 pwr qind, ose je jashtë". Një koncept i qartë, që zbulon se klubi e ka bërë zgjedhjen mes trajnerit dhe lojtarit me synimin për të eliminuar tensionin e krijuar gjatë këtyre javëve. I kthyer tek Junajted në verën e 2016-ës pas katër sezonesh të kaluar tek Juventus, Pogba nuk e ka justifikuar sh-

penzimin prej 120 milionë eurosh të bërë nga klubi anglez dhe mund të nxirret në merkato. Hipoteza Real Madrid dhe kthimi i bujshëm tek Juventus, që mund të rimarrë për "vetëm" 60 milionë euro, duken më të besueshmet. Por e ardhmja e Antonio Konte mund të jetë vendimtare për atë të francezit, i cili mund t'i bashkohet italianit në aventurën e tij të re, nëse do të ketë një të tillë.

Pak ditë pasi Paris Sen-Zhermen u eliminua në 1/8-at e Ligës së kampionëve, Nejmar i ka thënë të atit se nuk donte të vishte më fanellën e klubit francez dhe i ka kërkuar të negociojë transferimin e tij te Real Madridi sa më shpejtë të jetë e mundur. Sipas "ABC", braziliani ka vendosur të mos luajë më për ngjyrat e PSZH. "Nuk do të shkoj më në Paris, vendimi është i final," thuhet të jetë shprehur ai drejt familjes dhe shokëve. Nejmar Sr. Ka për detyrë të shfrytëzojë këto tre muaj teksa i biri i tij është i dëmtuar për të negociuar me presidentin Al-Khe-laifi dhe shefin e Real Madrid Florentino Perez. Nuk do të jetë e lehtë. Nejmar madje është gati të ulë pretendimet e tij financiare vetëm për të finalizuar transferimin. Ish-lojtari i Barcelonas mendon se nuk është pritur mirë nga tifozët, dhe nuk është ambientuar me pjesën më të madhe të skuadrës që prej transferimit të tij në verë. "Nëse vij këtu, një kampionat pa traditë, dhe më vërsëllesh, nuk dua të luaj për asnjë minutë tjetër këtu," është shprehur Nejmar drejt familjes së tij.

## TIFOZËT UZURPOJNË FUSHËN DHE KËRCËNOJNË FUTBOLLISTËT

### Kapiteni përleshet fizikisht

Mark Noble njoftoi se ai do të vetëmbrohet, pasi u përlesh me një tifoz, që bëri të shtunën invazion në fushën e "London Stadium" të Uest Hem. Tifozët tentuan të përballen me drejtuesit, pasi Ashlej Barnes dhe Kris Vud i dhanë fitoren Barnlej. Ndërkohë, në fushë Noble rrëzoi dhe hodhi tutje një tifoz, ndërkohë që një tjetër tifoz kishte rrëmbyer flamurin e këndit dhe e nguli atë në qendër të mesit të fushës. "Ata nuk janë të lumtur

me atë që po ndodh dhe ne do të marrim në dorë situatën. Ne e kuptojmë që ata ndihen të tërbuar, por ne do të humbim ndeshje, por sërisht do të na duhen tifozët t'i kemi në mbështetjen tonë. Ka shumë prej tyre që nuk janë të kënaqur dhe është një atmosferë e rëndë. Njerëzit duhet të kuptojnë që vërtetë mund të jemi pre, por ne duhet të vetëmbrohemi, disa tifozë pushtuan fushën, shumë po vraponin drejt presidentit, por



nëse ndonjëri më afrohet mua, unë do të vetëmbrohem. Për shkak se është një stadium i madh, është e vështirë që forcat e sigurisë të

ndalojnë të gjithë", deklaroi kapiteni i Uest Hem, Noble pas ndeshjes, në intervistën e dhënë për "Sky Sport".

## Katër skuadra mund të bojkotojnë Kupën e Botës

Ish-spiuni rus, Sergei Skripal dhe vajza e tij Yulia u gjetën pa ndjenja pasditën e së dielës në Salisbury të Britanisë së Madhe, pasi u ekspozuan ndaj një agjenti nervor. Dyshimet e para të autoriteteve britanike e lidhin sulmin me Rusinë, por mbeten për t'u provuar. E nëse provohen, Londra mund të vendosë që të reagojë në të gjitha fushat, përfshirë edhe sportin. Qe-

veria britanike është duke diskutuar një sërë opsionesh, që nga ndalimi i zyrtarëve për të ndjekur botërorin në Rusi, e deri tek bojkoti total i këtij evenimenti, duke tërhequr skuadrën e Anglisë. Në këtë nismë, thonë mediat britanike, Londra po lobon edhe me vende të tjera për të bojkotuar botërorin dhe duket se gatishmëri ka gjetur nga Australia, Polonia

dhe Japonia, të paktën deri më tani. "Një bojkot total i botërorit është në tryezë dhe po diskutohet mes morisë së opsioneve që po shqyrtojmë", citon "The Times" një burim nga Ministria Britanike e Mbrojtjes. Në rast bojkoti, Anglia rrezikon që të ndëshkohet me pezullim edhe nga botërori i 2022 në Katar. Botërori në Rusi nis më 14 qershor.



# DORËHEQJET E DEPUTETËVE, FILLIMI I FUNDIT I VETËVENDOSJE

Dje dha dorëheqje edhe deputetja Besa Baftiu, ndërsa Albin Kurti mohoi ndarjen në Vetëvendosje

Dorëheqjet në Vetëvendosje që kanë nisur më muajin e fundit të 2017-ës, e që po vazhdojnë edhe sot, kanë bërë që një pjesë e deputetëve të mos jenë më pjesë e strukturave të kësaj partie. Në dhjetor të vitit të kaluar, nisën të dalin hapur problemet e brendshme në Vetëvendosje, të cilat kishin nisur më shumë se një vit më herët, por mbaheshin fshehur nga publiku. E para që dha dorëheqje, ishte deputetja Aida Dërguti. Kjo dorëheqje erdhi në mesin e dhjetorit, pas publikimit të një bisede të brendshme në Viber në mes të disa anëtarëve të LVV-së në të cilën shihet se Dërguti i drejtohet me një fjalë fyese themeluesit të partisë, Albin Kurti. "Unë e di që shprehja ime ka nxitur reagime e shqetësime për natyrën e problemeve në Lëvizje. Por, shprehja ime (e papranueshme gjithsesi) duhet vënë përballë një fushate sistematike të shpifjeve, linçimeve e etiketimeve që ka ndodhur tash 1 vit", kishte shkruar ajo në letrën e dorëheqjes. Por, dorëheqjet e njëpasnjëshme vazhduan. Në ditën e dytë të vitit të ri, Vetëvendosjes iu largua kryetari i partisë, Visar Ymeri, i cili dha dorëheqje nga të gjitha pozitat në partinë që e drejtoi për gati tre vjet.

"Jap dorëheqje në shenjë mospajtimi me këto zhvillime dhe pasi nuk ia dola që t'i zgjidhja këto zhvillime. Shpresoj që kjo dorëheqje do të kuptohet si alarm për gjendjen që kemi ardhur dhe nga ata njerëz që kanë bërë linçime", kishte thënë Ymeri në ditën e dorëheqjes, më 2



ALBIN KURTI

**Nga Lëvizja VETËVENDOSJE! ka disa dorëheqje dhe dalje, që janë për keqardhje dhe të gabueshme, por në Lëvizjen VETËVENDOSJE! nuk ka as ndarje dhe as ndalje!**

janar të 2018-ës. Por 'alarmi' i dhënë nga i pari i Vetëvendosjes, nuk u ndal. Dorëheqjet vazhduan, jo vetëm nga deputetët e anëtarët tjerë, por edhe nga dy kryetarët e komunave që udhëhiqen nga kjo parti. Vetëm dy ditë më vonë, dorëheqje dha edhe nënkryetari i parë i kësaj partie, Dardan Sejdiu. "Ka kohë që ballafaqohemi me një problem brenda Lëvizjes Vetëvendosje, problem për të cilin kam qenë i informuar në intervale të ndryshme kohore dhe atë vetëm pjesërisht, i cili kohëve të fundit ka një intensitet më të shtuar e mediatizim të dëmshëm", kishte shkruar Sejdiu në letrën e dorëheqjes. Pas Sejdiut, dorëheqje dha edhe deputetja Shqipe Pantina, e cila tha se dorëheqja po bëhet për shkak të trazirave të fundit që i pati kjo parti. Listës së dorëheqjeve iu bashkua edhe deputeti tjetër, Faton Topalli. Në letrën e dorëheqjes Topalli për-

## Deputetët që njoftuan dorëheqjen nga strukturat e VV-së:

Dardan Molliqaj  
Visar Ymeri  
Dardan Sejdiu  
Aida Dërguti  
Shqipe Pantina  
Faton Topalli  
Driton Çausi  
Besa Baftiu  
Frashër Krasniqi

mendte edhe mospajtime me idenë e mosrespektimit të simboleve shtetërore. Listës së deputetëve të dorëhequr iu shtua edhe Driton Çausi, i cili në zgjedhjet e fundit lokale ishte kandidat për kryetar të Komunës së Gjakovës. Edhe deputeti Frashër Krasniqi dha dorëheqje me një letër nga burgu ku po

mbahej në lidhje me sulmin në objektin e Kuvendit të Kosovës. "Përmes kësaj letre jap dorëheqje nga pozita e delegatit të Këshillit të Përgjithshëm dhe çdo pozitë tjetër brenda organizatës, i vetëdijshëm që do të përballlem me po ato shpifje e sharje që u përballën shoqet e shokët e mi", tha Krasniqi. Dje nga të gjitha strukturat dha dorëheqje edhe deputetja Besa Baftiu. Ajo si arsye të dorëheqjes përmendi atë që e quajti fushatë linçuese. Janë përfolur në media edhe dorëheqjet e Dukagjin Goranit dhe Donika Kadaj-Bujupit, por ata nuk janë deklaruar zyrtarisht për to, ndërsa Fisnik Ismaili tha në një rast se po përtonte të jepte dorëheqje. Përveç deputetëve, anëtarëve të kryesisë e aktivistëve, nga Vetëvendosje kanë dhënë dorëheqje edhe dy kryetarë komunash që udhëhiqen nga kjo parti. Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti është ndër zyrtarët e parë që nuk jep dorëheqje vetëm nga pozitat udhëheqëse, por është dorëhequr nga Vetëvendosje. Dorëheqja nga të gjitha pozitat në Lëvizjen Vetëvendosje ka dhënë edhe kryetari i ri i Kamenicës, Qëndron Kastrati.

## Kroatët me listë të re, edhe 22 serbë akuzohen për krime lufte

Prokurorët kroatë kanë njoftuar se kanë akuzuar edhe 22 serbë etnikë për krime lufte të kryera gjatë konfliktit në vitet e 1990-ta. Zyra e prokurorit në Zagreb ka thënë përmes një deklarate dje se edhe 22 serbë kroatë janë akuzuar për vrasjen e 22 civilëve dhe dy zyrtarëve policorë, të cilët janë mbajtur në tri zona në lindje të shtetit më 1991. Serbët kanë qenë pjesë e një grupi paramilitar që ka vepruar në lindje, gjatë viteve 1991-95 në luftën mes kroatëve dhe forcave serbe të përkrahura nga Beogradi. Zyra e Prokurorit ka thënë se tetë të dyshuarit kanë urdhëruar 14 persona të tjerë "për rrahje dhe vrasje" të civilëve kroatë dhe për "marrjen ilegale të pengjeve". Akuzat po ashtu pretendojnë se tetë personat kanë urdhëruar njerëz të tjerë të "torturojnë dhe vrasin të burgosurit e luftës" dhe të djegin e shkatërrojnë shtëpitë dhe bizneset e tyre. Në akuzë pretendohet se të dyshuarit janë përgjegjës për granata, të cilat kanë vrarë civilët dhe u kanë shkatërruar pronat. Krimet e supozuara janë kryer në fshatrat Çetekovac, Balinci dhe Çojlug në Kroaci, në shtator të vitit 1991.

## Kosova sërish drejt INTERPOL-it dhe UNESCO-s

Afirmimi i shtetit të Kosovës në botë dhe anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë, është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës dhe në këtë aspekt institucionet e Kosovës janë duke bërë të gjitha përpjekjet për anëtarësimin e vendit në dy mekanizma ndërkombëtarë, në INTERPOL dhe në Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Kulturë, Shkencë dhe Arsime (UNESCO), konfirmojnë zyrtarët e ekzekutivit të vendit. Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, thotë për Radion Evropa e Lirë se ekzekutivi tashmë është duke pu-



nuar në përmbushjen e të gjitha kushteve për anëtarësim në këta dy mekanizma. "Sa i përket çë-

shtjeve teknike që duhet përmbushur, do të thotë, kriteret për INTERPOL, Qeveria e Kosovës është

gati dhe sigurisht që sivjet do të aplikojë. Kurse, edhe për UNESCO, Kosova tashmë është gati. Dy ligjet, për trashëgimi kulturore dhe për fetë, janë proceduar në Kuvendin e Kosovës. Dikasteret përkatëse vlerësojnë se Kosova i ka edhe numrat e nevojshëm (të vendeve që votojnë), që të bëhet pjesë e këtyre dy mekanizmave", thekson Matoshi. Kosova kishte aplikuar edhe vitin e kaluar për anëtarësim në mekanizmin ndërkombëtar policor, INTERPOL. Ajo ishte futur në agjendën e Komitetit Ekzekutiv të Interpolit, në mënyrë që të votohej për pranimin e saj në Asambleen e

Përgjithshme vjetore të kësaj organizate, e cila u mbajt më 17 shtator të vitit 2017, në Pekin. Përderisa Palestina dhe Ishujt Solomon ishin pranuar në këtë organizatë, Kosova kishte tërhequr kandidaturën e saj. Ndryshe nga mundësia e sivjetme që Kosova të aplikojë për në INTERPOL dhe eventualisht edhe të pranohet, mundësia eventuale e Kosovës për anëtarësim në UNESCO do të jetë vetëm në vitin 2019, kur edhe pritet Konferenca e Përgjithshme e kësaj organizate. Kosova tashmë ka dështuar një herë për t'u anëtarësuar në UNESCO.



## Fortifikim nga frika prej cunameve, të jetosh pas një muri buzë detit

Për banorët e rajonit Tohoku, që i mbijetuan cunamit të 11 marsit të vitit 2011, që shkatërroi brigjet japoneze duke u marrë jetën 2000 personave, ajo dallgë e errët është një kujtim i përditshëm. Kur kanë kaluar 7 vite nga cunami dhe nga tërmeti, që bashkërisht shkaktuan 15 mijë viktima, një mur gjigant prej çimentoje, 12 metra i lartë dhe 395 km i gjatë, mbron komunitetin nga fenomene të ngjashme në të ardhmen. Shumë qytetarë e priten pozitivisht idenë e murit, që ka kushtuar 12 miliardë dollarë, por me kalimin e kohës kritikantët u rritën. "Duket si një burg, edhe pse nuk kemi bërë asgjë të keqe", thotë një qytetar. Në qytetin Kesenuma, në mur ka edhe dritare të vogla. "Është qesharake", thotë një banor, që në tragjedi ka humbur shtëpinë dhe vëllain. "Është një tallje. Të gjithë këtu kemi jetuar duke parë detin. Prej brezash të tëra ka qenë kështu. Tani muri na ndan, është e papranueshme", thotë një tjetër qytetar. Ka edhe nga ata banorë që janë të shqetësuar se ky mur gjigant do të dëmtojë turizmin. Të tjerë thonë se nuk janë konsultuar në fazat planifikuese, apo se paratë e shpenzuara për murin janë hequr nga projekte të tjera si rindërtimi.



# NEKKAZ PAGUAN EDHE "GJOBAT E BURKËS" NË DANIMARKË

Rachid Nekkaz përveç 1.538 gjobave që ka paguar deri tani në gjashtë vende do të paguajë edhe gjobat për ndalesën e burkës në Danimarkë

Biznesmeni algjerian Rachid Nekkaz, i njohur për kundërshtimin e tij ndaj dënimeve për burkën që kanë hyrë në fuqi në disa vende të Evropës, njoftoi se përveç 1538 gjobave që ka paguar deri tani në gjashtë vende, do të paguajë edhe gjobat për ndalesën e burkës në Danimarkë. Biznesmeni algjerian i cili deri tani ka paguar edhe gjobat për ndalesën e burkës dhe mbulesës si rroba plazhi (burkini) në Francë, ka shpjeguar për Anadolu Agency (AA) iniciativën e tij në lidhje me gjobat që ndërhyjnë ndaj ambienteve jetësore dhe lirive të muslimanëve. Ai tha se ka vizituar Iranin më 8 mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me qëllim mbështetjen e lirisë së 29 grave të arrestuara për shkak se nuk dëshironin të mbanin burka, dhe se këtë herë ka mbërritur në Danimarkë për të kundërshtuar dënimet, gjobat kundër burkës. "Qëllimi i ndodhjes sime këtu nuk është të mbroj fenë, por të mbroj lirinë. Parimi i lirisë është një e drejtë globale. Për këtë arsye unë mbroj të drejtat e atyre të cilët në Evropë dëshirojnë të mbajnë burkën dhe të drejtat e atyre në Iran që nuk dëshirojnë ta mbajnë burkën.



Është shumë e rëndësishme që Qeverisë së Danimarkës t'i shpjegohet se gratë mbajnë burkën me dëshirën e tyre të lirë", theksoi Nekkaz. Rachid Nekkaz, i cili ka formuar një fond prej 1 milion euro për të paguar "gjobat e burkës", ka deklaruar se deri tani kam paguar 1538 gjoba për burkën në 6 vende si Francë, Belgjikë, Zvicër, Holandë, Austri dhe Gjermani. "Do të paguaj gjithashtu edhe gjobat në Dani-

markë. Së shpejti edhe gjobat në Bullgari. Për mua është shumë e rëndësishme që t'iu jap mesazhin qeverive në Evropë se 'nuk mund të bëni çfarë të dëshironi' në çështjen e kufizimeve të lirive.

Nëse një vend nxjerr ligj për gjobitje kundër atyre që dëshirojnë të mbajnë burkën, unë do të jemi personi i cili do të paguaj këto gjoba". "Për muslimanët që jetojnë në Evropë, situata do të

jetë shumë më e keqe", është shprehur Nekkaz, duke shtuar më tej se "Sepse qeveritë në Evropë nuk ofrojnë zgjidhje që muslimanët të përshtaten në Evropë. Komuniteti musliman në Evropë për këtë arsye duhet të jetë shumë më i fortë për të mbrojtur interesat e tij. Nëse situata vazhdon siç është tani, e ardhmja e muslimanëve në Evropë nuk është shumë e ndritshme".

## "NUK JEMI MË SHUMË SE 50 PERSONA"

Nga ana tjetër, Sara, një vajzë turke 30-vjeçare, e cila është lindur dhe rritur në Danimarkë dhe po përgatitet për universitet, mori pjesë në një protestë para parlamentit danez për të treguar se është kundër ndalimit të burkës. Duke vënë në dukje se nuk do të kenë mundësinë as të dalin në rrugë me vendosjen e ndalesës së burkës në Danimarkë, Sara tha se në vendin që ka një popullsi prej 5.7 milionë banorë nuk ndodhen më shumë se 50 gra që veshin burkën. "Ka një qëndrim negativ ndaj muslimanëve në Danimarkë dhe Evropë, ashtu sikurse qëndrimi

negativ ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore", është shprehur Sara. Ajo tha se gjobat e vendosura ndaj saj për shkak të burkës nuk janë të rëndësishme për të dhe se këtë pjesë as që e ka menduar. "Ndalësia e burkës e cila pritet të hyjë në fuqi në Danimarkë është vetëm një fillim. Aktualisht nuk e ndalojnë burkën për arsyen se nuk duket fytyra, por e ndalojnë sepse ne jemi muslimanë. Do të vijë një ditë që do të ndalojnë edhe shaminë mbulesën. Ndërsa më pas do të ndalojnë mishin hallall. Do të ndalojnë çdo gjë që u përket muslimanëve", tha Sara për AA.

## Palestina refuzon Trumpin për "mbledhjen për Gazën"

Mexhdelani tha se palestinezët kanë refuzuar ftesën nga SHBA për të "marrë pjesë në mbledhjen e cila do të zhvillohet në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar situatën ekonomike në Rripin e Gazës"



Anëtari i Komitetit Ekzekutiv të Organizatës Çlirimtare të Palestinës, Ahmed Mexhdelani, njoftoi se kanë refuzuar ftesën e SHBA-ve për të marrë pjesë në

mbledhjen e planifikuar për t'u zhvilluar në Shtëpinë e Bardhë, për të diskutuar situatën ekonomike në Gaza. Duke folur në radion "Zëri i Palestinës", Mexhdelani

tha se palestinezët kanë refuzuar ftesën e bërë nga përfaqësuesi special i Presidentit të SHBA-ve, Donald Trump, për Negociatat Ndërkombëtare, Jason

Greenblatt, për të "marrë pjesë në mbledhjen e cila do të zhvillohet në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar situatën ekonomike në Rripin e Gazës". Mexhdelani tha se takimi në fjalë do të mbahej në kuadër të projektit për të distancuar kauzën palestineze dhe jo për shqetësimet humanitare, dhe ka theksuar se burimi i problemeve të palestinezëve në Gaza është bllokada e zbatuar nga Izraeli. Mexhdelani tha se duhet të bisedohet për heqjen e bllokadës në Gaza dhe jo të flitet për zgjidhjet ekonomike, dhe shtoi se "për krizën në Gaza nevojitet zgjidhje politike dhe jo ekonomike". Përfaqësuesi special i Trumpit për Negociatat Ndërkombë-

tare, Greenblatt, kishte njoftuar se "në Shtëpinë e Bardhë do të zhvillohej një mbledhje për të gjetur zgjidhje mbi krizën e përjetuar në Gaza".

Shtetet e Bashkuara po planifikojnë të mbajnë një takim më 13 mars në Shtëpinë e Bardhë për të diskutuar mënyrat për të mbështetur Gazën, ku po përjetohej një krizë humanitare për shkak të bllokadës tokësore, ajrore dhe detare të zbatuar nga Izraeli që nga viti 2006. Sipas statistikave të fundit, nga rreth 2 milionë palestinezë jetojnë në Gaza, 80 për qind e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë. Shkalla e papunësisë në rajon thuhet se arrin në 46 për qind.



Nga Ramiz ABDYLI

# SERBIA PËRBALLË TAPIVE TË SANXHAKUT TË NISHIT

Shqiptarët ishin të pranishëm në Serbinë Jugore që nga mesjeta. Gjurmët e tyre në këto treva, duhet të jenë të mëhershme. Është thënë se ndonjë shqiptarë i këtyre trevave mori pjesë në betejën e Kosovës (1389). Historiografia serbe pretendon se shqiptarët depertuan në Serbi, si nizamë të ushtrisë osmane, për t'i paraqitur ata bashkëpueshtues, tezë tendencioze, pasi në radhët e kësaj ushtrie pushtuese janë shquar edhe serb, përfshi edhe ndonjë kjanz, siç ishte S.Lazareviqi, që mori pjesë me ushtrinë e tij në betejën e Angorës (Ankarasë), Kraleviq Marko etj. Gjithsesi çështja e pranisë së hershme të shqiptarëve në Serbi duhet mbetet të sqarohet nga historiografia jonë në mbështetje të argumenteve të qëndrueshme, që mund t'i bëjë ballë kritikës shkencore.

Dokumentet osmane, dhe dokumente të proveniencave të tjera kanë dëshmuar se shqiptarët në shek.18 përbënin shumicën e popullsisë në Sanxhakun e Nishit, kazanë e Vrajës, dhe Kazanë e Pirorit, që ishin pjesë të Vilajetit të Kosovës, i cili kishte statusin e një province në Perandorinë Osmane. Gjithnjë sipas këtyre dokumenteve, shqiptarët kishin një përqindje të vogël të popullsisë edhe në Sanxhakun e Smederevës, i njohur si Pashallëku i Beogradit. Njëra nga 12 nahijet e këtij sanxhaku, Nahija e Jagodinës, banohej me shumicë shqiptare. Është për të theksuar se shqiptarësinë e këtyre trevave e thotë edhe akademiku, dhe politikani serb, Vasa Çubriloqi, i njohur për qëndrimin e tij fashist ndaj shqiptarëve. Në Elaboratin e tij të vitit 1937 për shpërngulën e shqiptarëve nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë ai ka lavdëruar qeverinë e vendit të tij, që ia kishte dalë ta zhbente "pykën shqiptare që nga Jagodina" e në jug të saj. Prandaj, këto treva i ka cilësuar si Aranutluk (Vasa Çubriloqi, Politički uzroci na Balkanu od 1860-1880, GGD, So. C VI, Tom XVI, Belgrade, 1930, 43). Po kështu, edhe anglezi, Xhon Ros shprehet për shqiptarësinë e këtyre trevave: "Po thuaj popullsia e pjesës perëndimore të Sanxhikut të Nishit, janë shqiptarë, të besimit mysliman" (Nikola P. Ilić, Vojne operacije srpske vojske za oslobođenje Leskovca od Turaka 1877 godine).

Mbi bazën e argumenteve të mësipërme historiografia shqiptare i ka cilësuar trevat e mësipërme si Troje Etnike Veriore Shqiptare, rrjedhimisht troje etnike të

Dëbimi i shqiptarëve, myslimanëve e të tjerëve nga Sanxhaku i Smederevës, filloi që kur shpërtheu Kryengritja e Parë serbe (1804). Kryengritësit, të nxitur nga udhëheqësit e tyre, njëkohësisht u vërsulën egërsisht mbi ta, pa zgjedhur mjetet: bënë vrasje, dhunime, keqtrajtime, dhënia e flakëve shtëpive e objekteve...

Kosovës Verilindore (Kristaq Prifti, Popullsia e Kosovës, 2014; Gazmend Zajmi, në: Cjenocodi dhe aktet gjenocidale. . . , Prishtinë, 1995, 14).

## DËBIMI NGA SANXHAKU I SMEDERËVËS

Dëbimi i shqiptarëve, myslimanëve e të tjerëve nga Sanxhaku i Smederevës, filloi që kur shpërtheu Kryengritja e Parë serbe (1804). Kryengritësit, të nxitur nga udhëheqësit e tyre, njëkohësisht u vërsulën egërsisht mbi ta, pa zgjedhur mjetet: bënë vrasje, dhunime, keqtrajtime, dhënia e flakëve shtëpive e objekteve etj. "Bëmat" e tyre i ka pohuar edhe K.Nenadoviqi, biograf i udhëheqësit të kryengritjes, Karagjorgje Petroviqit, i cili midis tjerash thotë: "



(...) serbët e zemëruar vrisnin turqit kudo që i hasnin, nuk kursyen as të plagosurit, as fëmijët". Ndërsa historiani amerikan Philip Cohen, ka arritur në përfundimin se këto krime ndaj jo serbëve ishin të pëshembullts: "Fashizmi serb është me i vjetër se ai hitlerian, rrënjët e të cilit datojnë nga viti 1804" (Philip Kohen, Tajni rat Srbije, Zagreb 1997).

Është për të vënë në spikamë faktin se Serbia pati mbështetjen e gjithanshme të Rusisë dhe të Francës për dëbimin e shqiptarëve, e të jo serbëve nga Sanxhaku i Smederevës në Konferencën ndërkombëtare të Kalnixhes, pranë Stambollit (1862). Me insistimin e tyre, konferenca vendosi që jo serbët të "shpërngulehin sa më parë nga Principata e Serbi-

së". Përrjashtim do të bënin vetëm ata që do të deklaroheshin "myslimanë serb", apo romë. Për dëbimin përfundimtar të tyre nga territori i principatës serbe u sajua incidenti i njohur në Çukur Çezme, kur u vra djaloshi, Sava Petkoviqi (16 qershor 1862). Ndërkaq, për efekte të popullimit me të shpejtë të trevave të braktisura me serb, Princi serb, Millosh Obrenoviqi, nxori Ligjin e veçantë (1865), sipas të cilit kolonët që do të vendosehin në pronat e të dëbuarve, përjashtoheshin nga taksat dhe nga shërbimi ushtarak. Pasuan aksionet e ushtrisë serbe për dëbimin përfundimtar të gjithë jo serbëve. Këto aksione u shoqëruan edhe me plaçkitje, përvetësim të pasurisë dhe rrënimin e objekteve të të kultit islam (xhami e teqe).

## PASTRIMI ETNIK

### I SANXHAKUT TË NISHIT

Pastrimi etnik i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, Kazaja e Vrajës dhe Kazaja e Pirotit, ndodhi gjatë dhe pas Luftës serbo-osmane (1877-1878). Princi Milan Obrenoviqi, para se ushtria e tij të fillonte operacionet luftarake kundër ushtrisë osmane, do t'i drejtohej shqiptarëve me një Proklamata, me të cilën kërkonte që nëse nuk do të luftonin kundër ushtrisë së tij, ju garantonte jetën dhe paprekshmërinë e pronave. Ndërkaq, në Proklamata drejtuar ushtarëve të tij, ky sundimtar përkonte prej tyre që "Sa më shumë shqiptarë të shpërngulni, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja për Atdheun" (J. Hadzi Vasilevic, Arbanaska liga-Arbanautska kongra i srpski narod u turskom carstvu, Beograd 1909, 14). Ushtria serbe, e mbështetur nga ushtarë e instruktorë rusë, do t'ia dilte ta dëbonte ushtrinë osmane nga Sanxhaku i Nishit dhe trojeve për rreth, për një kohë relativisht të shkurtë (13 dhjetor 1877-5 shkurt 1878) dhe zbatoi me përpikëri urdhrin e sovranit të saj. Operacionet luftarake të saj, u pasuan njëkohësisht me vrasje, masakime, e keqtrajtime të mijëra burrave, dhunime të grave, rrënimin e shtëpive, vënien e zjarrit të shumë fshatrave e lagjeve shqiptare në qytete, shumë burra u hodhën në burgjet e Serbisë etj. Gjetën vdekjen, po kështu, edhe shumë shqiptarë të tjerë, sidomos fëmijë e pleq, që morën arratinë drejt Vilajetit të Kosovës, për të shpëtuar jetën. Këto masakra i kanë pohuar edhe disa dëshmitarë serb (S.Uka, Dëbimi me dhunë i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit



(18, 1995, 77-1878, në: Gjenocidi... , 74-75). Është për të theksuar se qeveria serbe urdhëroi të masakroheshin edhe shumë shqiptarë të tjerë që vendosën të ktheheshin në trojet e tyre, në verë të vitit 1878, pasi kuptuan se Kongresi i Berlinit (10. 06-10-07), ju garantonte atyre jetën dhe pronën, nëse dëshironin të jetonin në Serbi. Por kjo e drejtë iu mohua. Vetë Knjazi serb, Milan Obrenoviq, do të urdhëronte ushtrinë dhe xhandarmërinë e tij që këta të mjerët të dëboheshin, sikurse të tjerët më parë, pa zgjedhur mjetet (Nikola. P. Ilić, Oslobodjenje Južne Srbije 1877-1878, Beograd 1977, 19-23). Pasi masakra e radhës e ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe, ndërsa Fuqitë e Mëdha, garantuese të vendimeve të këtij kongresi, nuk e panë të arsyeshme të ndërmerrnin ndonjë hap për të parandaluar këtë akt barbar të Serbisë. Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, M. Piroqanac i arsyetonte këto veprime ndër kabinetet e qeverive të Fuqive të Mëdha se "Nëse nuk do t'i dëbonim nga këtu, do të na shkaktonin fatkeqësi". Po kështu, edhe Kryeministri, Jovan Ristić, e thotë se por të mos bëhej ky veprim "shqiptarët do t'i shkaktonin vështirësi shtetit serb, madje edhe luftë të përgjakshme" (J. Ristic, v. c. 241-247). Si rrjedhojë e dhunës, terrorit e gjenocidit të ushtrisë e të xhandarmërisë serbe, edhe Sanxhaku i Nishit, Kazaja e Pirotit, dhe Kazaja e Vrajë, do të ktheheshin në toka të pastra serbe, që kapnin një sipërfaqe prej rreth 12.000 km<sup>2</sup>. Gazmend Zajmi, duke trajtuar shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje, e ka cilësuar këtë akt si formë të gjenocidit: "Shpërngulja e qëllimshme dhe e dhunshme e popullatës është shënuar si krim gjenocidal në kuadër të krimit kundër njerëzimit" (G. Zajmi, në: Gjenocidi... , Prishtinë, 1995, 15).

#### ÇËSHTJA E PRONAVE TË PALUAJTSHME

Kongresi i Berlinit obligonte Serbinë me anë të dy neneve (35, 39), që të pranonte kthimin e shqiptarëve në trojet e tyre. Midis tjerash thuhej: "Në trevat e bashkuara të Serbisë, myslimanët dhe të krishterët duhet t'i gëzojnë të drejtat e barabarta qytetare dhe politike. Ata gëzojnë të drejtat e tyre mbi pronat e tyre. Ndërsa ata që nuk dëshironin të ktheheshin, mund ta jepnin tokën me qira, në formë gjysmatarie, rrjedhimisht ta shisnin (J. Ristić, Diplomatska istorija Srbije (1875-1878), knj. II, deo II, Beograd, 1898, 256-264). Princi serb, Milan Obrenoviq, përballë këtij obligimi deklaroi: "Njerëzit mund të kthehen e të jetojnë ku të duan në Principatën e Serbisë". Mirëpo, doli se premtimi i tij bëhej vetëm për efekte taktike kundrejt Fuqive vendimmarrëse së Kongresit të Berlinit. Për të pamundësuar jetësimin e këtyre neneve, qeveria e tij nxori një varg pengesash, për të pamundësuar realizimin e kësaj të drejte të ligjshme të shqiptarëve. Për dhënien e



**Pas dështimit të "përpjekjeve" të Portës së Lartë për kthimin e shqiptarëve në tokat e tyre në Serbi, qeveria serbe i pati duart e lira për ta zgjidhte çështjen e pronave të tyre përmes Ligjit mbi Reformën Agrare (01. 04. 1880). Sipas tij, të gjitha vendbanimet e shpopulluara do të "plotësoheshin me pronarë të rinj" (me kolonë serb R. A). Neni 4 i tij precizonte qartë: "Toka i përket atij që e punon". Serbia këtë hap e bëri me arsyetimin se shqiptarët nuk po ktheheshin në trojet e tyre, ndërsa Porta e Lartë nuk ishte e interesuar të zgjidhte çështjen e pronave të shqiptarëve, rrjedhimisht shtetasve të saj, pasi ajo tashmë kishte shtypur në gjak Lidhjen e Prizrenit**

tokës me qira, pronarët shqiptarë duhej t'i parashtronin kërkesë personalisht pushtetit vendor, që përbënte vështirësi për plot rreziqe; askush nuk e garonte jetën e tyre. Pra, pronarët shqiptarë e kishin vështirë të ndiqnin procedurën. Ndërkohë, qeveria serbe, një pjesë të pronave të shqiptarëve i tjetërsoi përmes ankandëve publike, me arsyetimin se po lahehin "borxhet e pronave të tokave ndaj shtetit serb". Pati raste kur pronarët shqiptarë të tokave që shkuan në Serbi për të zbatuar të drejtën mbi pronat e tyre, u dënuan me shumë vite burg, me arsyetimet nga më të ndryshmet.

Fuqive e Mëdha, vendimmarrëse të Kongresit të Berlinit, nuk ndërmorën ndonjë hap kundër Serbisë për të detyruar atë që të zbatonte dy nenet e përmendura. Kështu Serbisë iu lanë duart e lira për t'i kthyer tokat shqiptare në toka të pastra serbe. Edhe Perandoria Osmane nuk qëndroi në lartësinë e detyrës ndaj këtij problemi. Çështje e vërteta, ajo bëri ndonjë hap për zgjidhjen e tij, por këtë e bënte nga trysnia e krahut radikal të Lidhjes së Prizrenit, i cili ishte i vendosur të luftonte për çlirim e Trojeve Veriore të Vilajetit të Kosovës. Pra, qenë shqiptarët ata që vunë në lëvizje Perandorinë

Osmane, që ajo të bënte disa përpjekje, tek përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Stamboll, kinse interesohet për fatin e shtetasve të saj, të dëbuar me dhunë. Presionin diplomatik të saj, Serbia fillimisht e shpërfilli, me arsyetimin se "shqiptarët ishin shpërngulur vet, pasi kishin luftuar kundër ushtrisë së saj" (J. H. Vasilevic, v. c. 17-17). Por ky arsyetim nuk pëlqej nga përfaqësuesit diplomatikë rusë e britanikë në Stamboll. Ata kërkonin me ngulm kthimin e shqiptarëve në Serbi. Ngulmonte sidomos Rusia, përmes ambasadorit të saj në Stamboll, Labanov, e bindur se shqiptarët nuk do të qëndronin në Serbi, se do të ktheheshin atje ku ishin shpërngulur, siç vepruan turqit e Bullgarisë. Trysnia e qeverisë ruse për kthimin e shqiptarëve në trojet e tyre, detyroi Serbinë që të ndërmerrte ndonjë hap konkret, për zbatimin e neneve të përmendura të Kongresit të Berlinit. Në këtë kuadër, Kryetari i Qeverisë serbe, Jovan Ristić organizoi një takim midis përfaqësuesve të tij me përfaqësuesit e Lidhjes së Prizrenit (4 gusht 1879). Në takim përfaqësuesi i qeverisë serbe shprehu gatishmërinë për kthimin e shqiptarëve. Ndërsa, njëri nga përfaqësuesit shqiptarë, Zeqir Ahmeti deklaroi: "Mbretit tuaj nuk i besohet, sepse

ai nuk ka besë. Ai nuk e mbajti fjalën kur na garanoi se po të qëndronin urtë nuk do të ngiteshim, por ushtria serbe na dëboi të gjithëve me forcën e armëve" (J. H. Vasilevic. 17-19). Fjalët e tij demaskuan politikën dyfytërshe të qeverisë serbe, që pati për rrjedhojë dështimin e takimit.

Pas dështimit të "përpjekjeve" të Portës së Lartë për kthimin e shqiptarëve në tokat e tyre në Serbi, qeveria serbe i pati duart e lira për ta zgjidhte çështjen e pronave të tyre përmes Ligjit mbi Reformën Agrare (01. 04. 1880). Sipas tij, të gjitha vendbanimet e shpopulluara do të "plotësoheshin me pronarë të rinj" (me kolonë serb R. A). Neni 4 i tij precizonte qartë: "Toka i përket atij që e punon". Serbia këtë hap e bëri me arsyetimin se shqiptarët nuk po ktheheshin në trojet e tyre, ndërsa Porta e Lartë nuk ishte e interesuar të zgjidhte çështjen e pronave të shqiptarëve, rrjedhimisht shtetasve të saj, pasi ajo tashmë kishte shtypur në gjak Lidhjen e Prizrenit.

#### PSE DUHET TË PUBLIKOHEN TAPITË

Botimi i tapive të Sanxhakut të Nishit, e të trevave të tjera për rreth, të njohura si Troje Veriore Shqiptare, janë me peshë shken-

core, dhe me efekte politike. Përmes këtyre dokumenteve me interes të veçantë, do të dihej deri ku saktësisht shtriheshin këto troje, dhe cili ishte numri i bartësve të tapive, rrjedhimisht i pronarëve të pronave të paluajtshme. Nga ky numër do të rezultonte numri i përgjithshëm i shqiptarëve në këto troje, sepse nga autorë të ndryshëm shqiptarë janë dhënë shifra, me dallime mëdha, që shkojnë nga 150.000 deri 350.000. Përmes tapive do të saktësohej edhe numri i fshatrave në të cilët banonin shqiptarët, sepse studiuesit kanë dhënë shifra që dallojnë dukshëm midis, që shkojnë nga 656-700. Bymimi i shifrave, dhe i fakteve të tjera, nuk është në interes të historiografisë së Kosovës, sepse bie ndesh me të vërtetën.

Është me interes shkencor, që në arkivat e Turqisë, të Serbisë, e në ndonjë arkiv tjetër, të sigurohen informacione për numrin e saktë të shqiptarëve të vrarë, të keqtrajtuar, të arrestuar, të grave të dhunuara, të shtëpive e të lagjeve të qyteteve të rrënuara etj. Po kështu, do të ishte me interes të dihen detaje të tjera, që kanë të bëjnë me çështjen e tjetërsimit të pronave të paluajtshme të shqiptarëve të dëbuar, qëndrimin e Perandorisë Osmane ndaj këtij problemi, si dhe të shteteve vendimmarrëse të Kongresit të Berlinit. Botimi i tapive duhet të bëhet në gjuhën angleze, dhe të shpërndahet në qendrat vendimmarrëse politike, në Bruksel, Nju Jork, si dhe në shtetet evropiane e më gjerë. Përmes tyre, do të ndërjegjësoheshin qarqet vendimmarrëse politike për pastrimin e parë etnik të tokave shqiptare nga Serbia, rrjedhimisht për gjenocidin e parë të saj mbi shqiptarët. Mbase në këtë mënyrë do të diskreditohej politika shoviniste e Serbisë, që ka ndjekur me konsekuencë ndaj shqiptarëve dhe Kosovës në një periudhë mbi 200 vjeçare.

Kosova duhet ta plasojë të vërtetën e historisë së saj që nga Mbretëria e Dardanisë, tash e 2400 vjet më parë, e cila shtrihej nga Nishi e Piroti deri në Maqedoninë Veriore. Është për të vënë re se kufijtë e saj përkojnë përafërsisht me kufijtë e Vilajetit të Kosovës, i banuar me shumicë shqiptare. Të rikujtojmë se në marrëveshjen, e nënshkruar midis Komisionit të qeverisë osmane dhe përfaqësuesve shqiptarë të Kryengritjes së Përgjithshme në Shkup (18. 8. 1912), Perandoria Osmane njohu autonominë e Shqipërisë brenda katër vilajeteve të banuara me shumicë shqiptare, siç iu njohtë kjo e drejtë Serbisë e vendeve sllave dhe Greqisë. Por kjo e drejtë e ligjshme e Shqipërisë, nuk u jetësua, si rrjedhojë e Luftës së Parë Ballkanike. Ndërkaq, Fuqitë e Mëdha, të ndara në dy blloqe politike-ushtarake, vendosën t'ia jepnin më tepër se gjysmën e tokave shqiptare Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, për të kënaqur interesat e tyre imperialiste gjeopolitike.





# REZULTATE TË PAPRITURA: FËMIJË TË KËTILLË NË TË ARDHMEN DO TË FITOJNË MË SË SHUMTI

Fëmijët të cilët më herët i kanë përshkruar si të zellshëm, të mençur, me më së shumti potencial, madje edhe i kanë hasur në punë prestigjioze, mirëpo larg asaj që kanë fituar më së shumti

Hulumtimi i cili ka zgjatur 40 vjet, ka treguar se cilët fëmijë, me cilat karakteristika, bëhen njerëz të suksesshëm të cilët fitojnë më së shumti para, ndërkaq do të çuditëni sepse ajo karakteristikë kryesisht konsiderohet e padëshirueshme. Madje edhe vetë hulumtuesit janë befazuar me rezultatin. Hulumtimi është publikuar në portalin Developmental Psychology, ndërkaq ky hulumtim ka filluar në vitin 1968. Në të vërtetë, ato vite hulumtuesit patën filluar t'i studionin nxënësit e klasës së gjashtë të moshës 12 vjeçare. I kanë vëzhguar dhe i kanë shënuar të dhënat lidhur me inteligjencën, sjelljen, karakterin si edhe faktet lidhur me statusin socio-ekonomik të tyre dhe të prindërve të tyre. Pas dyzet vjetësh, ekipi ka takuar ish-nxënë-



sit e tyre. Fëmijët të cilët më herët i kanë përshkruar si të zellshëm, të mençur, me më së shumti potencial, madje edhe i kanë hasur në punë prestigjioze, mirëpo larg asaj që kanë fituar më së shumti.

Pikërisht në atë pikëpamje hulumtuesit më së shumti janë befazuar, sepse është treguar që më së


shumti para fitojnë çapkenët rebelë. Edhe pse shkencërisht nuk janë dëshmuar përse është saktësisht kështu, autorët konsiderojnë që kjo është për shkak që njerëzit më rebelë kanë shpirt më të fortë garues, nuk frikësohen të jenë vetvetja dhe luftojnë për idetë e veta dhe gjithashtu nuk frikësohen të

negociojnë për ngritje page apo për pagë më të madhe.

Hulumtuesit me atë rast nuk kanë përjashtuar mundësinë që të ardhurat më të larta të njerëzve rebelë mund të jenë rezultat i veprimeve të palejuara, mirëpo, diçka të tillë nuk ka treguar asnjë prej ish-nxënësve të tyre.

## Letra e Ajnshajtinit shitet në ankand për 100.000 dollarë

Një letër e shkruar nga fizikani Albert Ajnshtajn u shit dje në ankand për 103.700 dollarë (rreth 83.500 euro) në Jerusalemin. Dorëshkrimi mbi teorinë e relativitetit, i hartuar në gjuhën gjermane, u dërgua nga Albert Ajnshtajni në vitin 1928 në Berlin në adresë të një kolegut të tij matematikan. Blerësi ka preferuar të mbetet anonim. Disa objekte të tjerë, në mesin e të cilëve kishte disa letra, autografe dhe foto të Çmimit Nobel 1921 në Fizikë, u shitën për disa mijëra dollarë. "Këto letra nxjerrin në pah personalitetin kompleks të shkencëtarit të madh", u shpreh për median drejtori i kompanisë së ankandeve Winner's, Gal Wiener, transmeton ATSH raportimin e AFP-së. Në tetor 2017, një dorëshkrim i Albert Ajnshtanit për sekretin e lumturisë u shit në Jerusalem për 1,56 milionë dollarë, pas një vlerësimi fillestar mes vlerës 5 000 dhe 8 000 dollarë. Ajnshtajni refuzoi të zgjidhej presidenti i parë i Shtetit të Izraelit, por ka qenë drejtuesi jo-rezident i Universitetit Hebraik të Jerusalemit deri në vdekjen e tij në vitin 1955. Arkivat e Ajnshtajnit janë të aksesueshme për hulumtuesit në kampusin e universitetit, i cili zotëron gjithashtu dorëshkrimin e teorisë së relativitetit.



## Ofertë e veçantë për shoferët rreth 70 vjeç

Qyteti i Gjenevës, Zvicër, është duke zbatuar një ofertë të veçantë për t'i frymëzuar qytetarët e moshuar që të heqin dorë nga vozitja. 100 personat e parë të moshës rreth 70 vjeçare që heqin dorë nga patentë shoferi, do të marrin kartelën e transportit publik me gjysmë çmimi. Ndërsa tre personat e parë që heqin dorë do të përfitojnë transportin publik krejtësisht falas. Pla-

ni është hartuar nga udhëheqësit e kantonit të Gjenevës, në mënyrë që të moshuarit të marrin "vendimin e vështirë" për të hequr dorë nga patentë shoferi. Gjeneva është njëri nga qytetet më të dendura në botë. Një raport i fundit ka treguar se shoferët shpenzojnë mesatarisht 52 orë duke pritur në trafik çdo vit, apo 16 për qind të kohës së përgjithshme të vozitjes.



## Si të vendosim fjalëkalimin ideal në internet?

Ndonjëherë vendosim ta ndryshojmë shpesh duke rënë ndesh me atë që rekomandojnë ekspertët për krijimin e një fjalëkalimi, një përzjerje shkronjash dhe numrash që e bëjnë të vështirë memorizimin.

E vërteta qëndron se kur kemi të bëjmë me fjalëkalimet gjithmonë bëjmë gabime: studimi më i madh që është realizuar deri më tani mbi çelësin e lundrimit në interneti zbulon se më shumë se gjysma e përdoruesve i përdorin fjalëkalimet në mënyrë të përsëritur në llogari të ndryshme ose i

ndryshojnë ato fare pak – një modifikim që nuk garanton sigurinë.

Eksperti Gang Wang dhe 4 koleget e tij informaticiene nga Virixhia Uest kanë analizuar 61.5 milionë fjalëkalime të përdorura nga 28.8 milion njerëz gjatë 8 viteve të fundit të cilat janë bërë publike gjatë incidenteve të ndryshme të shkeljeve të të dhënave. Fjalëkalimet u përdorën në 107 lloje të ndryshme rrjetesh sociale ose motorë kërkimi, duke përfshirë Gmail, Myspace etj. 85% e përdoruesve që përdorin blerjet online përsërisin sërish fjalëkalime të njëjta, të cilat

i bëjnë të jenë me të ekspozuar nga sulmet kibernetike. Edhe për llogaritë e postës elektronike, rezultojnë se dy të tretat e përdoruesve përdorin fjalëkalime që i kanë përdorur diku tjetër. Duke pasur parasysh këto fakte lind pyetja si mund ta mbrojmë privatësinë në internet?

Për ekspertin Wang, është e rëndësishme që së paku të siguroheni që llogaritë më të ndjeshme dhe të rëndësishme të keni një password unik, ndërsa për llogaritë e vogla ne mund të përdorim edhe fjalëkalime të ricikluara.



Koha, e hënë 12 mars, 2018

## Jeta e luftëtarëve të pamëshirshëm

Dambe është një stil brutal luftimi që është shumë i përhapur mes të rinjve nigerianë. Me një grusht që përdoret për mbrojtje dhe me tjetrin të lidhur me copë për të bërë më shumë dëm, luftëtarët godasin pa mëshirë

njëri-tjetrin. “Është një traditë e lashtë në veri të vendit tonë. Duam ta përhapim edhe në jug këtë lloj luftimi. Duam të shikojmë dhëmbë të thyer”, thotë komentatori i luftimeve.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Sot dashuria do ju shpërblejë dhe kënaq duke ju bërë të merrni frymë lirish. Në mesin e shumë gjërave negative që kalojnë nëpër duart tuaja, të paktën marrëdhënia në çift ecën mirë! Hëna sot sjell miqësi të reja dhe shumë takime edhe për beqarët. Në punë do të shqetësoheni nga gracka të caktuara që vijnë nga kolegë ose bashkëpunëtorë të paskrupullt.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Hëna është në anën tuaj, në marrëdhënie favorizon optimizëm dhe pozitivitet. Shumë çifte do të jenë në procesin e marrjes së hapit të madh, të tjerët do të konsolidojnë një marrëveshje. Për beqarët është një e diel plot me surpriza, me dëshirën e madhe për të dalë dhe takuar njerëz të rinj. Një ditë e favorshme për aktivitete të reja, merrni frenat e një projekti me guxim dhe përgjegjësi.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Disa momente tensioni për shkak të angazhimeve të shumta mund të sjellin konflikt në çift. Gjeni një kompromis për t'i kushtuar pak kohë të dashurit/ës tuaj. Zemrat e vetmuara po presin për dashurinë e madhe dhe do vlerësojnë rezultatin e çdo takimi të ri. Ju keni një mijë qëllime për të arritur fitore në punë. Mos u dorëzoni, suksese të kënaqshme po vijnë.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Ju do të çlirohni nga një çështje e komplikuar sentimentale e cila ju ka ngarkuar me shqetësim kohët e fundit. Kjo do të rikthejë erosin dhe pasionin në çift! Takime interesante parashikohen edhe për beqarët, do arrihi të bëni për vete shumë persona vetëm me një shikim të thjeshtë! Në marrëdhëniet ndërpersonale dhe në karrierë, mos e nënvlerësoni Saturnin.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Venusi nuk është më në kundërshtim me shenjën tuaj dhe më në fund mund të gëzohesh! Projektet në çift do të ecin mirë dhe për ju do të lindi një qiell premtues. Dashuria gjithashtu triumfon edhe për beqarët, por kërkon pak vullnet të mirë dhe angazhim. Stresi me siguri nuk mungon, por sigurisht që shkon më mirë se ditët e fundit dhe tani e ardhmja profesionale duket më e qartë për ju.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Jepini një arsye, sot Venusi do t'ju vërë në një konfrontim mjaft të nxehtë me njerëzit rreth jush. Veçanërisht në marrëdhënien në çift do të ketë tensione dhe diskutime përtej masës! Beqarët do të kenë njohje të reja, por nuk do jenë të bindur për asgjë. Ndalni këmbënguljen tuaj në punë nëse nuk doni të gjeni veten vetëm, në vend që të sulmoni, përpiquni të zgjidhni mosmarrëveshjet.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Injoroni thashethemet dhe mos u ndikoni nga njerëzit që flasin rreth jush. Veproni me zemër dhe shprehni ndjenjat tuaja të dashurit! Ditë emocionuese edhe për beqarët që duan të gjejnë shpirtin binjak! Është një kohë e mirë për të shfrytëzuar një mundësi që do t'ju jepet për të përmirësuar situatën tuaj të punës.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Jupiteri dhe Dielli sot të favorshëm do t'ju bëjnë të kaloni një të diel fantastike, plot gëzim dhe pasion. Mbrëmje intensive me të dashurin/en tuaj! Për beqarët mund të ketë një zhgënjim nga ana e një personi, por vazhdoni të ecni përpara! Propozime interesante po vijnë dhe nga sot në jetën tuaj të punës fillon një ndryshim i vërtetë.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Ju jeni të shqetësuar dhe gjithashtu do të përfetoni një rënie të lehtë të humorit në një mënyrë të pakapërcyeshme. Për fat të mirë, dashuria do ta mbushë ditën tuaj që nga fillimi. Ka shumë mundësi për zemrat e vetmuara për të gjetur personin e duhur! Në sektorin profesional, ju do të donit gjithmonë të keni zgjidhjen e duhur për gjithçka.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Ju do t'ju duhet një pauzë për refleksim para se të shkoni në veprim dhe situata që keni në duart tuaja kërkon vëmendje maksimale. Hëna do të mbrojë marrëdhëniet sentimentale. Beqarët do të jenë disi të shqetësuar dhe do të duan të shpëtojnë nga rutina. Do të keni mundësi të zgjeroni projektet tuaj të punës për të arritur qëllimet e dëshiruara.




**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Dashuria po lulëzon dhe nëse jeni në çift për disa kohë ju do të rizbuloni se bashkimi është më i fortë se kurrë. Mbrëmje erotike, ju do të jeni të pasionuar dhe intrigues. Për beqarët do të ketë mundësi për rekreacion, do të keni mundësi të shkëlqyeshme për të rikuperuar një marrëdhënie. Do të jeni luftëtarë dhe do të përfitonin nga distancat që lidhen me punën për të treguar aftësitë tuaja.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Sot do të jeni në tension me partnerin/en tuaj ose me disa anëtarë të familjes. Lini mënjane problemet tuaja nga jeta private dhe mos i shkarkoni ato te të dashurit tuaj! Perspektiva të mira për beqarët të cilët mund të gëzojnë një periudhë relaksimi dhe pushimi. Përmirësoni pozicionin tuaj të punës, por mos i humbni sytë nga financa!



NE KETE DATE

<b>KOHA</b>	MOTI I NDRYSHUESHËM, MOTI I PAQËNDRUESHËM	FLUTURUESI I PARË MITOLOGJIK	LLOJ ZOGU, BREGCË	AUSTRIA	KËNGËTARI ITALIAN, AL PRAPA, PAS				QË I TAKON ISLAMIT
AKTORIA DHE KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO	HAJGARE								
<b>SH</b>				BANOR I BEOTISË					
AKTORIA AMERIKANE, XHUDI (NËNA E AKTORES NË FOTO)								SEVERXHANE LAÇI	E PËRKULI
NJË YJËSI E ZODIAKUT						ZAR (LAT.)			
TEMPERATURA		ONOMATOPE E GUGATJES			SPANJA		ANGSTREMI		METRI
		AUTORI KROAT, UJEVIQ			UJK (ARBËRISHT)		ATLETIKA (SHKURT.)		SEKONDA
FUTBOLLISTI I KAMERUNIT, SAMUJEL					AKTORI SPANJOLL, GUTIEREZ				
					OSMAN SHEHU				
OPERË E VERDIT									KELVINI
									1000 ROMAK
TË LËNIT ANASH, KERCIME									

ZGJIDHJET: B, NJERI, ULUR, JETË, OKËS, RT, I, KRIM, OZI, BANO, LIZA MINELI, SHAKA, BEOTAS, GARLAND, SL, ARIES, ALEA, T, GU, E, A, M, ETO, UNAKSI, RIGOLETO, K, ANASHKALIME.

## Sudoku

shumë i lehtë      mesatar

3	6			7			8		2	7						1	6
4			2		3		7			3		6				2	
							3			1	6			7	8	3	
	2		3	5	6		4				4		9				
9			1		2			3				1		6			
	3		7	9	4		2					3		9			
			6							4	7			2	3	8	
	9		8		5			6		8		5				9	
	5			6			9	2	1	9						5	7

Shumë i lehtë: 361579284, 489213675, 572648319, 128356947, 947182563, 635794821, 216937458, 794825136, 853461792. Mesatar: 278359416, 435618729, 916427835, 364295178, 729186543, 851734962, 547962381, 683571294, 192843657.

## Gratë kineze kryesojnë listën e miliardereve

Biznesmenët kinezë edhe këtë vit kryesojnë listën e grave miliardere, të cilat kanë fituar pasurinë e tyre me vetëpërpjekje. Në raportin e publikuar nga kompania e hulumtimeve "Hurun" lidhur me pasurinë globale 2018 shihet se në 4 vendet e para në listën e grave miliardere me pasuri të përfituar me suksesin e treguar në tregun e punës, e jo nëpërmjet martesës dhe trashëgimisë, janë radhitur gratë kineze. Pronarja e kompanisë "Lens Technology", e cila prodhon xhama për ekranin e gjigandëve të elektronikës si Apple dhe Samsung, Zu Kunfei me pasurinë prej 9.8 miliardë dollarë zë vendin e parë në këtë listë. Zë e cila vjen nga një familje rurale me të ardhura të ulëta në listën e grave më të pasura të "Forbes"-it, të publikuar javën e kaluar ishte radhitur në vendin e 16-të. Pas saj në listën e "Hurun" pasojnë kinezet Vu Yajun dhe Çen Lihua, të cilat janë aktive në fushën e ndërtimit. Pasuria e Yajun është 9.1 miliardë dollarë ndërsa ajo e Lihua 8.1



miliardë dollarë. Në vendin e katërt të listës me një pasuri prej 7.5 miliardë dollarë ndodhet Zang Yin, pronare e kompanisë Nine Dragon, e cila vepron në fushën e letres dhe të paketimit. Përveç Kinës, në shkallët më të larta në mesin e grave miliardere është edhe amerikania Diane Hendricks. Themeluesja e kompanisë për produkte të çatave dhe dritareve, Diane Hendricks, me pasurinë e saj prej 6.2 mi-

liardë dollarësh të përfituar me vetëpërpjekje u radhit në vendin e 5-të. Kinezja tjetër, Vu Çunyuan, pronare e kompanisë për prodhimin e sistemeve të zërit "Audio Technology", me një pasuri prej 4.9 miliardë dollarë u radhit në vendin e 7-të së bashku me dy biznismene tjera nga Evropa. Në listën e "Hurun"-it nga 102 gra miliardere me përpjekjet e veta, 64 janë biznismene kineze.



## Truri ndalon së prodhuari neurone të kujtesës në moshën 13 vjeç

Pjesa e trurit përgjegjëse për nxënien dhe kujtesën duket se ndalon së prodhuari qeliza që në moshën 13- vjeçare, sipas një studimi që transmeton raportimin e AFP-së. Zbulimi ka ngritur peshë fushën e neuroshkencës, duke vënë në pikëpyetje një koncept ku të gjithë hulumtuesit ishin të një mendimi. Deri më tani, shumë shkencëtarë besonin se tek njeriu, zona e hipokampusit vijonte të prodhonte në një moshë madhore qindra neurone të reja çdo ditë, në të njëjtën mënyrë si tek gjitarët e tjerë. Studimi i publikuar nga "Nature" dhe i kryer nga hulumtuesit amerikanë dhe spanjollë bazohet tek analizimi i trurit në një target grup prej 59 fëmijësh dhe të rriturish. "Nuk gjetëm asnjë gjurmë të neuroneve të reja dhe as të qelizave burimore që prodhojnë neurone nga ndarja në hipokampuset e individëve mbi 18 vjeç", sqaroi për median një nga autorët, Arturo Alvarez-Buylla (Universiteti i Kalifornisë në San Francisko).

## Shokuese! 54 duar njerëzish gjenden në akull në Siberi

27 palë duar njerëzish, të shkëputura misteriozisht janë gjetur në një ishull të mbuluar me akull në Rusi. Zbulimi tronditës u bë pranë qytetit të Khabarovskit në Lindjen e Largët të Siberisë, afër kufirit me Kinën. Të gjitha, 54 duart ishin në një thes. Një tjetër, i parë nga një banor lokal, ishte shtrirë veçmas në një ishull të mbuluar me dëborë në lumin Amur rreth 18 kilometra në drejtim të rrymës nga kufiri rus me Kinën. Ato ishin vendosur në një vend popullor për peshkimin, por vendasit thanë se nuk kishin parë ndonjë gjë të dyshimtë së fundmi. The Siberian Times tha se ishte një "mister fakti se kujt i përkisnin duart, kur u copëtuan dhe pse". Gjurmët e gishtërinjve u gjetën në një rreth anë dhe të tjerët u kontrolluan. Një teori e tmerrshme është se duart mund të ishin eliminuar si një dënim për vjedhje. Një tjetër është se duart u ndanë nga trupat e vdekur në një spital – por është e paqartë pse kjo mund të ndodhte.



## Në Iran ka 15 mijë të veja nën 15 vjeç

Anëtarja e Këshillit Bashkiak të Teheranit, Shahrbanoo Amani ka thënë se në të gjithë vendin janë 15 mijë vajza nën moshën 15 vjeç të cilat janë martuar në moshë të vogël dhe më pas janë ndarë. Sipas Agjencisë së Lajmeve të studentëve iraniane ISNA, Amani ka theksuar problemet e grave në vend gjatë një fjalimi në "Kongresin Kombëtar të Grave të Suksesshme të Iranit" i cili është zhvilluar në Universitetin "Shehit Beheshti" në kryeqytetin e Iranit, Teheran. Ajo tha se ka disa ligje në Iran që kufizojnë të drejtat e grave, por se shpresojnë që këto kufizime të hiqen. "Në vend ka 15 mijë të veja nën moshën 15 vjeçare", tha Amani. Duke vënë theksin se kontributi i grave në ekonominë e vendit është shumë i rëndësishëm, Amani shtoi se kontributi i grave në vend për ekonominë duhet të rritet edhe më shumë.



KALENDARI HISTORIK 12 MARS

1350 - Qyteti i Orvietos deklaroi se do të tua presë kokën dhe do të i hedhë në zjarr çifet herreje-krishtere.  
1365 - Themelohet Universiteti i Vjenës.  
1496 - Hebrejtë dëbohen nga Siria.  
1609 - Bermuda shpallet koloni angleze.  
1642 - Abel Tasman bëhet evropiani i parë që zbarkon në Zelandë të Re.  
1737 - Trupi i Galileo Galileut zhvendoset në Kishën Santa Krose në Firencë të Italisë.  
1773 - Jeanne Baptiste Pointe de Sable zbuloi vendbanimin që sot quhet si Çikago.  
1799 - Austria i shpall luftë Francës.  
1867 - Trupat e fundit franceze largohen nga Meksika.  
1884 - Mississippi themelon kolexhin e parë shtetëror amerikan për femra.  
1934 - Josip Broz (Tito) lirohet nga burgu.  
1945 - BRSS i kthen Transilvaninë Rumanisë.  
1971 - Qeveria turke e Demirelit detyrohet nga ushtria të jep dorëheqje.  
2003 - Vritet Kryeministri i Serbisë, Zoran Djindjic në Beograd.  
2003 - Elizabeth Smart që ishte shpallur si e zhdukur gjendet pas nëntë muajve.

Më 9 mars të vitit 1562 në Napoli të Italisë, puthja në publik u ndalua me ligj edhe u bë e dënueshme me vdekje. Nëse autoritetet shihnin ndonjë çift duke u puthur, atëherë pasonte dënimi me vdekje. Institucionet ishin të shqetësuara për moralin dhe shëndetin publik. Mirëpo, ky veprim ndikoi shumë pak në përhapjen e murtajes në Evropë. Ky duket të ishte vetëm fillimi i historisë së ndalimit të puthjeve në publik. Në vitin 1910 Franca ndaloi puthjet në stacione sepse konsideronin që puthjet po vononin mjetet e transportit. Përgjatë historisë kontrollimi i marrëdhënieve seksuale ka qenë shpesh pjesë e censurave.



Si porosit biondina një kafe të mesme?  
I porosit tre kafe dhe e pi atë të mesit.

\*\*\*

Biondja duke ecur rrugës e ndalë një kalimtar rasti:  
- Më fal a e di se çfarë do të thotë "I don't know" në shqip?  
- Nuk e di!  
- O Zot askush nuk po e din!



Pleqëria është e trishtë, jo sepse nuk ka më gëzime, por për shkak se mbarojnë shpresat.  
(Shamfor)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS